



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”
Kolegji Universitar “Bedër”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. As. Ana KTONA 

Dr. Elior VILA 

Nëntor / 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” ofruar nga Instituoni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “BEDËR”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “BEDËR”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Kompjuterike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 350, datë 17.06.2019
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 Vite/ 6 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE/ 12 PAK v.a. 2021-2022 9 PAE/ 10 PAK v.a. 2020-2021 8 PAE/ 12 PAK v.a. 2019-2020
18	Numri i studentëve:	32 Studentë v.a. 2021-2022 20 Studentë v.a. 2020-2021 17 Studentë v.a. 2019-2020
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "Beder" (KUB) është një institucion jopublik i arsimit të lartë, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë. 06.04.2011 me emertimin Shkollen e Lartë Private "Hena e Plote (Beder)". KUB i është akorduar akreditimi i pare institucional dhe i programeve të studimit me Urdher Nr. 223, datë 04.06.2013. Akreditimi institucional është bere në përputhje me vendimin nr. 469, date 03.05.2013 të Keshillit të Akreditimit. KUB është riakredituar nga ASCAL me ane të Vendimit të BA Nr. 101, date 10.11.2017 dhe me pas sipas Vendimti të BA Nr. 57, date 16.12.2021 për një periudhë 5 vjecare deri në 15.12.2026.

Kolegji Universitar "Beder", e ka seline në Rrugën Jordan Misja, kompleksi USLUGA. Ai perbehet nga dy njësi kryesore që janë Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtesise dhe Fakulteti i Teknologjise dhe Biznesit si edhe një Qender Kerkimore. Statuti i KUB, në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", është miratuar me Vendim Senati Akademik të KUB nr. 7, datë 21.07.2016 dhe me pas është ndryshuar me Vendim Senati Akademik të KUB Nr. 2, date 05.11.2018 dhe Nr. 11, date 22.09.2021.

Hapja e programit të studimit Bachelor në **Shkenca Kompjuterike** është realizuar nëpërmjet Urdhërit të MASR Nr. 350, datë 17.06.2019. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Shkencave Kompjuterike, njësi përbërëse e Fakultetit të Teknologjise dhe Biznesit.

Programi i studimit Bachelor në **Shkenca Kompjuterike** ofrohet me kohë të plotë në gjuhën shqipe, me kohëzgjatje 3 vite akademike të ndara në 6 semestra dhe është organizuar në bazë të sistemin Europian të transferimit të krediteve në 180 kredite ECTS. Cdo vit akademik përmban 60 kredite të ndara nga 30 kredite në semestër. Qëllimi i këtij programi studimi është përgatitja e specialisteve në fushën e Shkencave Kompjuterike të cilët do të jenë të aftë të programojnë dhe zhvillojnë software të avancuar, të administrojnë bazat e të dhenave, të zhvillojnë aplikacione mobile dhe ato web si edhe të konfigurojnë sistemin kompjuterik në baze të kërkesave të përdoruesit etj. Programi i studimit ofrohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e KUB.

KUB ka aplikuar në ASCAL për akreditimin e programit të studimit Bachelor në **Shkenca Kompjuterike** me Nr. 164 Prot, më datë 01.06.2021 ndërsa dosja e dokumentacionit të akreditimit është dërguar në 23.02.2022. Në këtë mënyrë, kemi të bëjmë me akreditimin e parë të këtij programi studimi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Burimi parësor i informacionit për GVJ-ne ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në periudhën Janar-Shkurt 2022. Ky Raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur KUB për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. KUB, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër eviencash mbështetëse.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr.531, datë 11.9.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr. 370, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizmin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

GVJ gjatë vlerësimit të jashtëm u mbështet nga specialisti i ASCAL, MSc. Muhamed Prezja. Takimet në institucion, u zhvilluan sipas programit të miratuar paraprakisht nga ASCAL. Takimet konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Dekanin e Fakultetit të Teknologjise dhe Biznesit dhe Përgjegjës të Departamentit të Shkencave Kompjuterike, Grupin e Vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, studentët, përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerezore dhe Protokoll-Arkivit, përfaqësues të Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, përfaqësues të Komisionit të Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin, përfaqësues të Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Zyrës së Përzgjedhjes si dhe përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë.

Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj.

Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Kolegji Universitar “Bedër” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 24. 10.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 107/17 Prot, datë 24.10.2022. Kolegji Universitar “Bedër” përcjell në ASCAL më datë 27.10.2022, me anë të shkresës me Nr. 283 Prot, datë 25.10.2022, ”Komente rreth Draft Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkencat Kompjuterike”

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Kolegji Universitar “Bedër”, GVJ konstaton se programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Misioni i Kolegjit Universitar “Bedër” [dok DVV Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër (1), neni 4, pika 1;] është të përgatisë individë të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë. Pjesë e misionit të Kolegji Universitar “Bedër”, [dok DVV Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër (1), neni 4, pika 1.d;] është të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit. Gjithashtu, pjesë e misionit të Departamentit të Shkencave Kompjuterike, që ka si program Bachelor në Shkenca Kompjuterike, është të formojë specialist me kompetenca të zgjedhura praktike në fushat e implementimeve të sistemeve informatike. [Kolegji Universitar Bedër (beder.edu.al)]
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi i statutit të Kolegji Universitar “Beder” [dok DVV Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër (1), neni 4] dhe planit strategjik [Dok DVV Evidenca nr. 12 Plani Strategjik 2018-2023] vlerësohet se programet e studimit, përfshirë programin Bachelor në Shkenca Kompjuterike, synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Nga statuti i Kolegjit Universitar Bedër [dok DVV

	<p>Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, neni 4] citojmë: “Traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, janë baza e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të mira, ndërkombëtare në përgjithësi dhe ato europiane në veçanti”. Nga planin strategjik [Dok DVV Evidenca nr. 12 Plani Strategjik 2018-2023: Pozicioni Strategjik I Kolegjit Universitar “Bedër”] citojmë:” Misioni i Kolegjit Universitar "Bedër" është përgatitja e individëve të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si dhe mbështetja e kërkimit shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë” si dhe 'Programet e studimit në të dyja ciklet organizohen në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara nga “Karta e Bolonjës” dhe legjislacioni shqiptar për arsimin e lartë.’</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit [dok DVV Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, neni 4; dok DVV Evidenca nr. 12 Plani Strategjik 2018-2023, Misioni & Profili i Kolegjit Universitar “Bedër”;] konstatohet se programi studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike është hartuar në përputhje me qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë së Kolegjit Universitar “Bedër”. Nga plani strategjik [dok DVV Evidenca nr. 12 Plani Strategjik 2018-2023] citojmë: ‘Misioni i Kolegjit Universitar "Bedër" është përgatitja e individëve të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si dhe mbështetja e kërkimit shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë.’ dhe [dok DVV Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, neni 4, pika 2.a] citojmë:” Kolegji Universitar Jopublik “Bedër”, në të gjithë veprimtarinë e tij, ka për qëllim: a. të përgatisë specialistë të lartë me dije të nivelit bashkëkohor në fushën e shkencave islame, jurisprudencës, shkencave të komunikimit, ekonomisë, biznesit, teknologjisë së informacionit, shkencave kompjuterike, shkencave të edukimit, gjuhëve të huaja, duke zhvilluar programe studimi në profilet përkatëse në auditorë etj.;”</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike ofrohet në një nga fushat në të cilën Kolegji Universitar Jopublik “Bedër” ka qëllim të përgatisë specialistë të lartë, atë të Shkencave kompjuterike. Ndër qëllimet e programit është edhe “përgatitja profesionale e studentëve në aplikimin e njohurive të informatikës në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe shoqërisë në përshtatje të vazhdueshme me tregun e punës.”[dok DVV Evidenca nr. 27 Shtojca për Bachelor në Shkenca</p>

	Kompjuterike]			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	<p>Kolegji Universitar “Bedër” ofron programe të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në fushën e shkencave humane, sociale, shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit. [dok DVV Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, neni 4; dok DVV Evidenca nr. 12 Plani Strategjik 2018-2023]</p> <p>Në Planin Strategjik të tij thuhet shprehimisht: “Kolegji Universitar “Bedër” synon të shndërrohet në një institucion arsimor me karakter ndërkombëtar, duke ofruar mundësi studimi jo vetëm për shqiptarët, por edhe për të huajt, duke kontribuar në promovimin e Shqipërisë si një qendër rajonale e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”.</p> <p>Në [dok DVV Evidenca nr. 15 Studim tregu i programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike] është paraqitur një analizë mbi perspektivën e shkencave kompjuterike dhe teknologjive të informacionit realizuar nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike, ku theksohet lidhja e ngushtë e kësaj fushe me çdo sektor të shoqërisë. Nga website i Kolegjit Universitar “Bedër”[https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-shkenca-kompjuterike-2-10/616/647] citojmë: Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike ka si mision kryesor t’i përgatisë studentët me njohuri bazë teorike dhe aplikative në fushën e shkencave kompjuterike si dhe në disiplina mbështetëse, të formojë specialist me kompetenca praktike në fushat e dizenjimit dhe implementimit të sistemeve informatike që ata të operojnë si specialistë dhe t’u përgjigjen nevojave të teknologjisë së informacionit në sektorin publik ose privat ku janë të angazhuar.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në	GVJ konstaton se programi i studimit është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit [dok DVV Evidenca nr. 12 Plani Strategjik 2018-2023; Profili i Kolegjit Universitar “Bedër”] në të cilën shkenca kompjuterike është përcaktuar si një

përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	nga fushat ku KUB ofron programe studimi.			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti i KUB përcakton qartë drejtimit prioritar akademike të tij. Në [dok DVV Evidenca 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, neni 4, pika 2.a;] thuhet shprehimisht se: Kolegji Universitar Jopublik "Bedër", në të gjithë veprimtarinë e tij, ka për qëllim të përgatisë specialistë të lartë me dije të nivelit bashkëkohor në fushën e shkencave islame, jurisprudencës, shkencave të komunikimit, ekonomisë, biznesit, teknologjisë së informacionit, shkencave kompjuterike, shkencave të edukimit, gjuhëve të huaja, duke zhvilluar programe studimi në profilet përkatëse në auditorë Rregullorja e programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike] është në përputhje me Statutin dhe rrjedh nga ajo, Rregulloren Themelore dhe Rregulloren e Organizimit Akademik të KUB [dok DVV Evidenca 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër; dok DVV Evidenca nr. 17 Rregullorja Themlore; dok DVV Evidenca nr. 18 Rregullorja mbi Organizimin Akademik].			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike, emërtohet, organizohet, strukturohet dhe ka përmbajtje në përputhje me fushën akademike shkenca kompjuterike e cila është një prej fushave/drejtimeve akademike të KUB. [dok DVV Evidenca 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër; dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të publikuar në website të KUB, GVJ konstaton se në programin e studimit përshkruhen qartë objektivat e

<p>formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>mësimdhënies dhe se ky program realizohet në përputhje me këto objektiva. Nga shqyrtimi dokumentacionit rezulton se programi i Ciklit të Parë Bachelor në Shkenca Kompjuterike, është hapur në përputhje me kërkesën e tregut për specialist të kësaj fushe të konstatuar nga institucioni në studimin e tregut. [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Evidenca nr. 15 Studim tregu i programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike; https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-shkenca-kompjuterike-2-10/616/647</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni ka realizuar studimin për tregun e punës përpara hapjes së programit. [dok DVV Evidenca nr. 15 Studim tregu i programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike]. Në këtë studim përfshihet informacion mbi kërkesat e punëdhënësve në fushën e shkencave kompjuterike dhe mundësitë e punësimit të studentëve të programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike në tregun rajonal, kombëtar e ndërkombëtar. Zyra e të diplomuarve harton raporte të cilat përmbajnë të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin e studentëve të diplomuar në KUB [dok DVV Evidenca nr. 19 Raport i Zyrës së të Diplomuarve, viti 2019-2020] Sipas këtij raporti përqindja e kategorisë “të punësuar dhe/ose vazhdojnë studimet master” te studentët që kanë përfunduar studimet në programet Bachelor në KUB është 81% ndërsa te studentët që kanë përfunduar studimet në programet Master në KUB është 84% .</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formuese struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike, rezultatet e pritshme të të nxënit [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Evidenca nr. 30 Rregullorja e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit; https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-shkenca-kompjuterike-2-10/616/647 garantojnë përftimin e dijeve, aftësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. [dok DVV Evidenca nr. 15 Studim tregu i programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike] Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike ofron njohuri teorike dhe praktike në: Sistemet Inteligjente; Rrjetet Kompjuterike; Inxhinieri Softi; Sigurinë e të Dhënave; Krijimin dhe Menaxhimin e Bazave të të Dhënave; Programim të Orientuar</p>

	në Objekte; Programim Mobile; Programim në Web; Zhvillimin dhe Testimin e Software-ve; Këto njohuri garantojnë punësimin e studentëve si: zhvillues te aplikacioneve softuer; inxhinier softi; analist i sistemeve kompjuterike; konfigurues/mirëmbajtës i rrjetave; administrator i bazës së të dhënave; administrator i sigurisë <i>etj</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	GVJ konstaton, nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizitave në institucion, se KUB ka përvojën (eksperiencë 10 vjeçare në fushën akademike), kapacitetet si në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse dhe burimet e duhura në fushën e shkencave kompjuterike. Personeli akademik në programin e studimit është i kualifikuar, me një përvojë shumëvjeçare në këtë fushë studimore dhe aplikative, gjë që mundëson rritjen e cilësisë së mësimdhënies. [dok DVV CV-të e stafit akademik].
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Njësia kryesore, Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, ofron programe studimi në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike që prej vitit 2018. Kjo njësi kryesore ofron gjithashtu dy programe të tjera në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike: Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi dhe Program Profesional 2 vjeçar “Programim në Web”. Programi Bachelor në Shkenca Kompjuterike ka si fushë të përgjithshme dhe specifike fushën e Shkencave Kompjuterike. GVJ konstaton se aktiviteti mësimor-kërkimor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike është në përputhje me një nga fushat akademike e kërkimore të Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit, fushën e shkencave kompjuterike. [dok DVV Evidenca nr. 28 Organigrama e Kolegjit Universitar Bedër; dok DVV Evidenca nr. 20 Organigrama e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit; dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike; https://www.beder.edu.al/sh/content/default/rreth-

	fakultetit-7-15/657/658].			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi Bachelor në Shkenca Kompjuterike ofrohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është Shkenca Kompjuterike. Këto fusha janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. [dok DVV Evidenca nr. 28 Organigrama e Kolegjit Universitar Bedër; dok DVV Evidenca nr. 20 Organigrama e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit; dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/rreth-6-4/0/651]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ndarja e detyrave mes njësisë e personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloret e tij [dok DVV Evidenca nr. 17 Rregullorja Themlore; dok DVV Evidenca nr. 18 Rregullorja mbi Organizimin Akademik;] Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Shkencave Kompjuterike menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të parë Bachelor ne Shkenca Kompjuterike i cili ka një kohëzgjatje 3-vjeçare dhe në total përmban 180 kredite. [dok DVV Evidenca nr. 30 Rregullorja e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit; dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; Evidenca nr. 75 Raporti vjetor institucional 2020-2021]
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të	GVJ konstaton se, Kolegji Universitar “Beder” ka bashkëpunime ndërinstitutionale me institucione shtetërore dhe IAL brenda vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të

<p>studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>biznesit ose tregut të punës</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 25 Lista e bashkëpunimeve dhe MOU; dok DVV Evidenca nr. 24 Marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të Erasmus me Universitete në Rumani dhe Kroaci; dok DVV RVB, Tabela 5]</p> <p>Ndër këto bashkëpunime mund të përmendim North American College Houston, Texas; Universiteti i Tiranës; Aldo Moro University, Itali; bashkëpunime në kuadër të shkëmbimit të studentëve dhe stafit, bashkëorganizimit të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta kërkimore. West University of Timisoara dhe Aurel Vlaicu University of Arad Rumani; The College of Applied Sciences “Lavoslav Ružička” Kroaci si institucione partnere për Erasmus+ International Credit Mobility. Bashkia e Elbasanit në kuadër të trajnimeve të stafit, bashkëorganizimit të aktiviteteve shkencore, praktikave studentore. S&T Albania, Atom Computers për praktikat profesionale.</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike në raportin vjetor të tij paraqet një analizë të bashkëpunimit me aktorët e jashtëm në kuadër të procesit mësimor dhe formues.</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 26 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2020-2021]</p> <p>Bashkëpunimi me aktorët e jashtëm, në kuadër të procesit mësimor dhe formues, ka bërë të mundur realizimin e workshopeve të ndryshme si workshopi me temë: “Zhvillime teknologjike në biznes në tregun shqiptar” ku prezantuan përfaqësues të kompanive të ndryshme si: përfaqësues të kompanisë elitare në ofrimin e shërbimeve IT “S&T Albania” e cila është pjesë e grupit S&T një kompani ndërkombëtare, e cila është aktualisht kryesisht e fokusuar në dizejnimin dhe prodhimin e paisjeve Internet of Things (IoT); përfaqësues i kompanisë Novotek (Hikvision and Mikrotik Partner) i cili trajtoi komponentët kryesorë të sistemeve të sigurisë, aksesin remote, aksesin dhe njoftimet e automatizuar, integrimin e sistemeve të zjarrit, alarmit dhe kamerave në dedektimin dhe menaxhimin më të mirë të problematikave që mund të hasen me këto sisteme; përfaqësues nga kompania ATOM Computers (HP Business Partner dhe Lenovo ISG Partner) i cili trajtoi rëndësinë e certifikimeve të IT dhe në përfitimet e shumta që sjellin këto certifikime si në zhvillimin profesional po ashtu edhe në zhvillimin e një karriere të qëndrueshme; përfaqësues nga kompania duapue.com e cila trajtoi mundësitë për zhvillimin e karrierës që ofron duapune.com</p>

	<p>nëpërmejt shërbimit të këshillimit të karrierës, intershipeve, praktika profesionale etj. Bashkëpunimi me disa institucione publike dhe private ka bërë të mundur realizimin e praktikave profesionale. Ndër institucionet kryesore në të cilat janë organizuar praktikat profesionale janë AKCESK, Robustek, Codecon VR, Big Media Expert etj.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>GVJ konstaton se, KUB ka marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me disa institucioneve, organizatave dhe bizneseve te ndryshme për kryerjen e praktikave profesionale [dok DVV Evidenca nr. 25 Lista e bashkëpunimeve dhe MOU; dok DVV Evidenca nr. 24 Marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të Erasmus me Universitete në Rumani dhe Kroaci; dok DVV RVB, Tabela 5]. Studenteve u ofrohet mundësia të shprehur kerkesat e tyre për realizimin e praktikës [dok DVV Evidenca nr. 56 Formular aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale]. Praktikant studentore të realizuara gjatë vitit 2020-2021 janë paraqitur në raportin e departamentit të Shkencave Kompjuterike. [dok DVV Evidenca nr. 26 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2020-2021] Disa nga institucionet në të cilat u organizuan praktikat profesionale janë AKCESK, Robustek, Codecon VR, Big Media Expert. Gjatë vizitës në institucion u përmend gjithashtu bashkëpunimi dhe me kompaninë ATOM computers për realizimin praktikave. AKCESK (Autoriteti Kombëtar Per Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë), RobusTech AI (kompani që ofron edhe konsulencë IT për subjekte të ndryshme që kërkojnë shërbime si: sisteme smart solutions, sisteme sigurie, rrjete kompjuterik etj), Big Media Expert (që ka si specialitete: Web Development, Web Design, Web Marketing, Social media, Mobile Development, User interface, Brand naming, Brand design, Brand protection, Brand strategy, Copywrite, System cpm, E-commerce, Seo, SEM, Web analysis, Key advertising, Email marketing, Android apps, and Iphone apps) si dhe Atom Computers (që ka si aktivitete kryesore: Sisteme ICT, Pajisjet, Zhvillim Softuari, Pajisje Sigurie) janë disa nga kompanitë që i shërbejnë programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Programi Bachelor në Shkenca Kompjuterike është hapur për herë të parë në vitin akademik 2019-2020 dhe si i tillë nuk ka realizuar akoma trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II.ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ konstaton se programi i ciklit të parë Bachelor në Shkenca Kompjuterike është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi [VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018] dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 3 vite dhe në total 180 kredite. [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike;]
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	Programi i ciklit të parë Bachelor në Shkenca Kompjuterike synon t'i përgatisë studentët me njohuri bazë teorike dhe aplikative në fushën e shkencave kompjuterike si dhe në disiplina mbështetëse, të formojë specialist me kompetenca praktike në fushat e dizenjimit dhe implementimit të sistemeve informatike që ata të operojnë si specialistë dhe t'u përgjigjen nevojave të teknologjisë së informacionit në sektorin publik ose privat ku janë të angazhuar. [https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-shkenca-kompjuterike-2-10/616/647] GVJ konstaton se programi i ciklit të parë Bachelor në Shkenca Kompjuterike, nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara krijon mundësinë e formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Silabuset e lendeve] Studimi i Tregut [dok DVV dok

	<p>DVV Evidenca nr. 15 Studim tregu i programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike] evidentoi disa specialitete për të cilat formohen studentët e këtij programi. Studentët e diplomuar në këtë program mund të punojnë si zhvillues të aplikacioneve softuer (desktop, web, mobile); inxhinierë softi; analist të sistemeve kompjuterike; konfigurues/mirëmbajtës të rrjeteve kompjuterik; administrator i bazës së të dhënave; testues software-i dhe sigurues të cilësisë etj</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Silabuset e lendeve; dok DVV Evidenca nr. 27 Shtojca për Bachelor në Shkenca Kompjuterike; https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-shkenca-kompjuterike-2-10/616/647] dhe intervistave gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se programit te ciklit të parë Bachelor në Shkenca Kompjuterike, u jep njohuri studentëve në fushën e Shkencave Kompjuterike, ku një vend të konsiderueshëm në program zë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës së Shkencave Kompjuterike.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i ciklit të parë Bachelor në Shkenca Kompjuterike synon, ndër të tjera: përgatitjen e studentëve në fushat bazë të informatikës teorike dhe të aplikuar; aftësimin e studentëve për të analizuar dhe dizenuar sisteme informatike në funksion të fushave të ndryshme të shoqërisë; përfitim nga ana e studentëve të njohurive bazë dhe të thelluara të zgjidhjes së problemave reale informatike; përfitim nga ana e studentëve të njohurive bazë në shkencat kompjuterike rreth gjuhëve të programimit, sistemeve informatike, sistemeve të operimit, bazave të të dhënave. [dok DVV Evidenca nr. 27 Shtojca për Bachelor në Shkenca Kompjuterike; https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-shkenca-kompjuterike-2-10/616/647]</p> <p>GVJ konstaton se ky objektivi përmbushet mjaft mirë dhe kjo rezulton e shprehur qartë në rregulloren e programit dhe programet lëndore të tij. [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Silabuset e lendeve;]</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuar në</p>	<p>GVJ konstaton se Programi i ciklit të parë Bachelor në Shkenca Kompjuterike përmban të shprehura shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj., të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike;</p>

akte ligjore e nënligjore.	dok DVV Evidenca nr. 27 Shtojca për Bachelor në Shkenca Kompjuterike; https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-shkenca-kompjuterike-2-10/616/647			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga shqyrtimi i programit mësimor [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike;] rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në [VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018] dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh. Përqindja sipas secilit tip të komponentit mësimor është:			
	<ul style="list-style-type: none"> • lëndët bazë 20% • lëndët karakterizuese 54% • lëndët ndërdisiplinore 12% • lëndët plotesuese 10% • detyrimet përmbyllëse 4% 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Institucioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Kolegji Universitar Beder është akredituar për herë të parë në vitin 2013 [dok DVV Evidenca nr. 2 Urdhër nr 223, datë 4.06.2013 “Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit”;]. Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr. 101, datë 10. 11. 2017 e riakreditoi Kolegjin Universitar Beder deri në vitin 2021. [dok DVV Evidenca nr. 3 Vendim i BA Nr. 101, datë 10.11.2017 Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar Bedër] dhe vendimi i Bordit të Akreditimit, nr.57, datë 16.12.2021 u riakreditoi Kolegjin Universitar Beder deri në vitin 2026 [dok DVV Evidenca nr. 4 Vendimi i Bordit te Akreditimit, nr.57, date 16.12.2021 Per akreditimin periodik te IAL Kolegji Universitar Beder]

	<p>Njësiti kryesore të Kolegjit Universitar “Bedër” janë riorganizuar me Urdhër nr. 200, datë 3.7.2020 “Për riorganizimin e njësive kryesore të Kolegjit Universitar “Bedër”. [dok DVV Evidenca nr. 6] Rezulton se Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje:</p> <p>Departamentin e Shkencave Kompjuterike Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshem dhe Inovacion</p> <p>[dok DVV Evidenca nr. 20 Organigrama e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Departamenti i Shkencave Kompjuterike si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Kompjuterike zgjedh koordinatorin e programit të studimit me vendim të Keshillit të Departamentit [dok DVV Evidenca nr. 29 Vendimi për caktimin e Koordinatorit të Programeve Bachelor, viti akademik 2020-2021]</p> <p>Sipas RVB, koordinatori i programit të studimit është funksion ndihmes akademik me karakter administrativ. Ai kryen detyrat e ngarkuara dhe merr masat e nevojshme në funksion të mbarevajtjes së programit. Msc. Klevis Topi është koordinatori i programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike në KUB.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia kryesore “Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit” është riorganizuar me urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 200, datë 3.7.2020 “Për riorganizimin e njësive kryesore të Kolegjit Universitar “Bedër”. [dok DVV Evidenca nr. 6] Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Kompjuterike është hapur me urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 350, datë 17. 06. 2019. [dok DVV Evidenca nr. 5 Urdher nr. 350, date 17.6.2019 për hapjen e prog. Bch në Shkenca kompjuterike]. Nga shqyrtimi i CV-ve të stafit akademik rezulton se ata janë të specializuar në fusha specifike të cilat mbulojnë më së miri të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, gjë që garanton formimin e specialistëve të fushës me aftësi tepër të larta. [dok DVV CV-të e stafit akademik]</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për</p>	<p>Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit për vitin akademik 2021-2022 ka në përbërje të tij 21 anëtarë personel akademik të brendshëm (PAE), nga të cilët 1 Prof. As., 8 Dr., 1 Dr. proces, 11 Msc. Ndërsa PAK 12 nga të cilët 3 Dr. Dhe 12 Msc.</p>

numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Departamenti i Shkencave Kompjuterike përbëhet nga 7 anëtarë të personelit akademik të brendshëm (PAE), nga të cilët 3 janë me Dr., 1 Dr. Proc., dhe 3 Msc, ndërsa përsa i pëket stafit akademik me kontratë (PAK) janë 12, dhe në përbërje kanë 3 Dr., dhe 9 Msc. Departamenti është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. [dok DVV RVB Anëks: Numri i personelit akademik për çdo njesi baze: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontrate (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmes Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1 dhe 2)]			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3


Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ konstaton se Departamenti Teknologjisë dhe Biznesit disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: Rregulloren dhe programin mësimor [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike;], syllabuset [dok DVV Silabuset e lendeve] Ngarkesën [Dokumente nga vizita në institucion: Ngarkesa mesimore e Bachelor Shkenca Kompjuterike e perditësuar Viti akademik 2021-2022], etj.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se veprimtaritë formuese janë shpërndarë në përputhje me VKM 41. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën mëposhtë: <ul style="list-style-type: none"> • LËNDË BAZË (A): 20% (36 kredite)- përqindja e lejuar 15-20 % • LËNDË KARAKTERIZUESE (B): 54% (97 kredite)- përqindja e lejuar 50-55 % • LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE (C): 12% (22 kredite)- përqindja e lejuar 12-15 % • LËNDË LËNDË PLOTËSUESE (gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale) (D): 10% (18

	<p>kredite)- përqindja e lejuar 10%</p> <ul style="list-style-type: none"> • DETYRIME PËRMBYLLËSE (E): 4% (7 kredite)- përqindja e lejuar 3-5 % <p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit, planit mësimor dhe syllabuseve, GVJ konstaton se programi përmban 30 lëndë + 2 lëndë me zgjedhje + Praktikën + Punimin e Diplomës/Provimin e Mbrojtjes. Në syllabuset e lëndëve paraqitet qartë ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar, laborator). [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Silabuset e lendeve]</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike;] rezulton e shprehur qartë shpërndarja e krediteve në 6 semestra e tre vite akademike dhe për secilën lëndë apo veprimtari brenda programit [dok DVV Silabuset e lendeve]. Ky program rezulton me 30 kredite për semestër, 60 kredite në një vit të plotë akademik dhe 180 kredite në total.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ konstaton se plani mësimor [dok DVV dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike;] përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Frekuentimi dhe ndjekja e programit përcaktohen në rregulloren e programit [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike;] dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohet te syllabuset [dok DVV Silabuset e lendeve]</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe rregullorja e transferimit të studimeve [dok DVV dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike, Neni 5; Evidenca nr. 32 Rregullorja e Transferimit të Studimeve], përmban të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me pranimin, regjistrimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. GVJ citon nga rregullore programit: Kriteret e pranimit të studentëve miratohen nga Senati Akademik brenda periudhës së përcaktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe dërgohen në institucionet e MASR, QSHA dhe RASH. Kriteret publikohen në portalin U-Albania i cili është i aksesueshëm nga institucionet. Kriteri i notës mesatare është në masën 70% dhe kriteri i intervistës është në masën 30%</p>
<p>Kriteri 6. Programet e</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se syllabuset e</p>

<p>studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>lëndëve janë të paraqitur në strukturë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, dt. 24. 01. 2018. [dok DVV Silabuset e lendeve; dok DVV Evidenca nr. 31 Shembull syllabusi CMP 111 Hyrje ne algoritem dhe programim].</p> <p>Programet lëndore përmbajnë të gjitha informacionet, sipas formatit të miratuar nga VKM nr. 41, datë 24.01.2018, si titullari i lëndës, tipologjia e lëndës sipas klasifikimeve dhe llojin (e detyrueshme apo me zgjedhje), përmbledhja dhe rezultatet e të nxënit; konceptet themelore; numri i orëve të leksioneve, seminarëve, punëve të laboratorit, praktikave të ndryshme, konceptet kryesore dhe tematikat që do të trajtohen, format e frekuentimit dhe të kontrollit të dijeve dhe mënyrat e vlerësimit dhe pikëzimit të studentit etj.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ konstaton se, program i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike është në përditësim: propozohen ndryshime në kurrikulën e programit të studimit nga njësia bazë dhe miratohen nga Senati Akademik brenda [dok DVV Evidenca nr. 34 Praktika e ndryshimit në kurrikul] Sipas RVB, stafit akademik i kërkohet të përditësojë syllabuset në fillim të vitit akademik. [dok DVV RVB]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.4</p> <p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se programi studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike është i organizuar në 3 vite akademike, me 180 kredite në total. [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike;] Konstatohet se ky program është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe</p>	<p>GVJ konstaton se emërtimi i programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike është në përputhje me fushën akademike të tij. Shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e</p>

<p>praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike. [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Silabuset e lendeve;] Praktikant në institucione të ndryshme ju mundësojnë studentëve aftësimin dhe në disa raste punësimin e studentëve. [dok DVV Evidenca nr. 26 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2020-2021; Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Silabuset e lendeve;] dhe vizita në institucion [Vizita në Institucion: Takim me Studentët; Takim me Stafin akademik te programit], GVJ konstaton se mundësohet arritja e objektivave formues të programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. Programi Bachelor ne Shkenca Kompjuterike ka një strukturë të qartë dhe të mirëorganizuar të lëndëve. Ky program përmban 33 lëndë, praktikën profesionale dhe temën e diplomës. Organizimi i lëndëve bëhet në 5 disiplina në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Plani mësimor realizohet në 6 semestra me nga 30 kredite. Për një kredit realizohen 25 orë mësimore. Në çdo semestër 750 orë mësimore. Ngarkesa mësimore në auditore për tre semestrat e parë është 24 orë në javë, për semestrat 4 dhe 5 është 20 orë në javë, ndërsa për semestrin e fundit është 18 orë në javë. Programi mësimor është hartuar me objektiva të qarta dhe pritshmëri për studentët në fund të diplomimit të tij të cilat GVJ i gjen të shprehura në evidencen 27 [dok DVV Evidenca nr. 27 Shtojca për Bachelor në Shkenca Kompjuterike] dhe https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-shkenca-kompjuterike-2-10/616/647. Çdo syllabus është hartuar për të dhënë një konceptim të organizimit të lëndës duke pasqyruar edhe objektivat dhe rezultatet e pritshme për studentët. Programi mësimor monitorohet nga departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe njësitë si NJSBC, të cilët garantojnë mbarëvajtjen e tij dhe cilësinë.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Silabuset e lendeve;] dhe vizita në institucion [Vizita në Institucion: Takim me Studentët; Takim me Stafin akademik te programit] GVJ konstaton se lëndët janë në përputhje me profilin e programit dhe, rrjedhimisht, të domosdoshme për formimin e specialistëve në fushën Shkenca Kompjuterike dhe se raporti teori praktikë</p>

	<p>është në përputhje me profilin e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike. Raporti teori/ praktik në lëndët karakterizuese — përgatitje për disiplinën shkencore është kryesisht 50 % / 50%. Me kalimin e semestrave pesha e ngarkesës mësimore praktike rritet. Në vitin e tretë lëndët kanë të gjitha një raport teori praktik 50%/50%.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Gjatë intervistave me personelin akademik dhe me studentët [Vizita në Institucion-Shënime: Takim me Studentët; Takim me Stafin akademik te programit] dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Silabuset e lendeve;] evidentohet se raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe formimin e specialistëve të aftë në fushën e shkencave kompjuterike. GVJ konstaton se në planin mësimor të paraqitur nga GVB, në vitin akademik 2021-2022 rezultojnë 1890 orë mësimore në auditor, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1200 orë leksione - 210 orë seminare - 480 orë ushtrime dhe laboratorë - Totali 1890 orë mësimore në auditor <p>si dhe 60 orë praktikë profesionale. 56.7% të orëve mësimore janë orë punë individuale të studentit.</p> <p>Raporti teori/praktike është 61.5%/ 38.5%.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion [Vizita në Institucion: Takim me Studentët; Takim me Stafin akademik te programit] dhe informacionit në faqen web [Kolegji Universitar Bedër (beder.edu.al)]</p> <p>https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-shkenca-kompjuterike-2-10/616/647/?_con=0&cid=3835 u konstatua se syllabuset ngarkohen në sistemin informatik Beder Information System (BIS) bashkë me përditësimet e nevojshme duke përcaktuar edhe literaturën e detyruar dhe literaturën ndihmëse, të cilat duhet të jenë të 5 viteve të fundit. <i>Konstatohet se disa syllabuse nuk e kanë literaturën të viteve të fundit</i> [dok DVV Silabuset e lendeve;]. Sipas RVB, syllabuset ngarkohen në fillim të çdo semestri vitit akademik [dok DVV RVB]</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike ka përmbajtje didaktike dhe profesionale</p>

<p>garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>formuese dhe garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli bachelor. [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Evidenca nr. 27 Shtojca për Bachelor në Shkenca Kompjuterike; dok DVV Silabuset e lendeve;]</p> <p>Synimi i programeve bachelor është të përgatisë specialistë të lartë me dije të nivelit bashkëkohor në fusha të ndryshme të jetës; të përgatisë individë të kualifikuar dhe qytetar për të përmirësuar jetën e njeriut dhe mbarë shoqërisë;</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të aftësojë studentët për të punuar në një ambient multidisiplinar • të aftësojë studentët për të komunikuar qartësisht me shkrim apo nëpërmjet prezantimeve koncepte teknike. • të aftësojë studentët në të analizuarit, projektuarit dhe në implementimin e zgjidhjeve software të orientuara nga objektet për probleme reale. • të përgatisë profesionalisht studentët në aplikimin e njohurive të informatikës në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe shoqërisë në përshtatje të vazhdueshme me tregun e punës. • të aftësojë studentët për të analizuar dhe dizenuar sisteme informatike në funksion të fushave të ndryshme të shoqërisë; <p>Përmbajtja e programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike granton jo vetëm përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara në fushën e shkencave kompjuterike (duke ofruar lëndë si Hyrje në Algoritme dhe Programim; Struktura të Dhenash; Programim i Orientuar ne Objekte; Organizimi Kompjuterik; Bazat e të Dhënave; Programim në Web; Rrjetat pa Tela dhe Mobile; Siguri të Dhënash; Inxhinieri Softwerike; Nderfaqe Perdoruesi; Testim Software dhe Sigurimi i Cilësisë; Rrjetet Kompjuterike;) por edhe aftësimin për punë kërkimore dhe formimin si qytetar duke ofruar lëndë si: IT, Ligji dhe Shoqëria dhe Metoda Kërkimore dhe Shkrim Akademik</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike u jep mundësi të vijojnë studimet e mëtejshme në programet e ciklit të dytë dhe të pozicionohen në karrierën e tyre të ardhshme profesionale në fushën e shkencave kompjuterike. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion, GJV</p>

studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	konstaton se, programi i studimit duke kombinuar teorinë me praktikën siguron aftësi dhe kompetenca në fushën e shkencave kompjuterike në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Silabuset e lendeve; dok DVV Evidenca nr. 15 Studim tregu i programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike]			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	GVJ konstaton se janë organizuar takime të studentëve me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës duke i orientuar rreth kërkesave dhe pritshmërive të punëdhënësve eventuale të mundshëm. [Kolegji Universitar Bedër (beder.edu.al) https://cmp.beder.edu.al/sh/news/activities/vizite-studimore-ne-landmark-communications/1679]. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, u konstatua një bashkëpunim shumë i ngushtë me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës të cilët ishin ftuar të jepnin mësim. [Vizita në Institucion: Takimi me stafin akademik]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit [Dokumente nga vizita në institucion: Ngarkesa mesimore e Bachelor Shkenca Kompjuterike e perditësuar Viti akademik 2021-2022] rezulton se numri i personelit akademik me kohë të plotë që angazhohet në programin e studimit është 11 nga të cilët 4 me gradë shkencore dhe 7 anëtarë me Msc. Numri i personelit akademik me kohë të pjesshme që angazhohet në programin e studimit është 15 nga të cilët 3 me gradë shkencore Doktor dhe 12 anëtarë me Msc. Pika 6 e nenit 59 të ligjit 80/2015 përmbushet. Bazuar në këtë dokumentacion raporti ngarkesë mësimore PAE/ ngarkesë mësimore PAK është 69%/31% .
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në	Modulet mësimore mbulojnë nga pedagogë të cilët kanë gradë shkencore doktor ose janë MSc. Bazuar në dokumentacionin [Dokumente nga vizita në institucion: Ngarkesa mesimore e

<p>realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Bachelor Shkenca Kompjuterike e perditesuar Viti akademik 2021-2022] dhe në dokumentacionin [dok DVV CV-të e stafit akademik] personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit [dok DVV CV-të e stafit akademik] GVJ konstaton se personeli akademik i programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike ka njohuri në përputhje me natyrën e programit. Rezulton se personeli akademik i programit është i specializuar në fusha specifike të cilat mbulojnë më së miri të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, gjë që garanton formimin e specialistëve të fushës shkenca kompjuterike me aftësi tepër të larta.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar Bedër ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e institucione të sektorit publik [dok DVV Evidenca nr. 25 Lista e bashkëpunimeve dhe MOU; dok DVV RVB, Tabela 5] KUB ka bashkëpunime me disa institucione të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani si: Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti i Aleksander Moisiu, Këshilli i Europës, Atom Computers, RobusTech AI, Bashkia e Tiranës, Këshilli i Ministrave etj që kanë vendosur në dispozicion të KUB personelin të duhur e të kualifikuar. Në fillim të çdo viti akademik, çdo departament zgjedh një këshilltar karriere me vendim të Këshillit të Departamentit pranë Zyrës Së Planifikimit Të Karrierës [dok DVV Evidenca nr. 22 Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës] e cila ndër të tjera organizon takime prezantuese të studentëve të diplomuar dhe institucioneve të sektorëve të ndryshme për informimin e studentëve me profesionet përkatëse, eksperiencat e punës dhe mundësitë e karrierës. Këtë vit studentët nuk kanë zgjedhur punim diplome për detyrimin përmbyllës. [Vizita në Institucion]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve</p>	<p>Gjatë vizitës në ambientet e shkollës (klasat /labororet ku bëhet mesim nga studentet e këtij programi) GVJ konstatoi se mirëmbajtja e laboratorëve kryhet nga IT. Kolegji Universitar Bedër ka dy laboratorë Informatike të pajisur me kompjutera bashkëkohore (hardware), si edhe me programet përkatëse që i</p>

laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	nevojiten programit të Shkencave Kompjuterike. [Vizita në institucion;] [dok DVV RVB: Shtojca: Mjediset e fakultetit/Njesive baze, Tabela 16] [dok DVV Evidenca nr. 68: Specifikime Teknike per laboratorin e kompjuterave]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit [dok DVV Evidenca nr. 36 Guida e Stafit; Evidenca nr. 38: Udhezimi mbi funksionimin e Bibliotekes; Evidenca nr. 39: Udhezim mbi mesimdhënien e distance; Evidenca nr. 45 Lista e trajnimeve për stafin] GVJ konstaton se KUB në nivel institucional harton udhëzues, manuale dhe organizon trajnime të vazhdueshme për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se strukturat përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik [dok DVV Evidenca nr. 17 Rregullorja Themlore; Evidenca nr. 18 Rregullorja mbi Organizimin Akademik.; Evidenca nr. 75 Raporti vjetor institucional 2020-2021; Evidenca nr. 41 Rregullore e anketave dhe vlerësimeve; Evidenca nr. 42 Anketa e studentit ndaj lëndës] Strukturat përgjegjëse të sigurimit të cilësisë janë: Komisioni i Përhershëm Për Garantimin e Standardeve të Cilësisë


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<p>Institucionale dhe “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”. Nga rregullorja themelore [dok DVV Evidenca nr. 17 Rregullorja Themelore: neni 14] citojmë: “Komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit është organi përgjegjës që vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion, në përputhje me standardet shtetërore.” Ky komision ka ndër funksionet e tij “Monitorimin e sigurimit të cilësisë së stafit akademik”. Aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik kontrollohen periodikisht nga “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”. Bazuar në rregulloren e NJSBC proceset e vlerësimit janë periodike, kryesisht vjetore nga ana e NJSBC-së [dok DVV Evidenca nr. 44 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies duke ju dhënë mundësi atyre të plotësojnë një pyetësor [dok DVV Evidenca nr. 41 Rregullore e anketave dhe vlerësimeve; Evidenca nr. 42 Anketa e studentit ndaj lëndës;] në fund të çdo semestri. Pyetësori realizohet me të gjithë studentët në lidhje me lëndët përkatëse dhe lektorët e tyre. Gjatë vizitës në institucion [Vizita në Institucion-Shënime: Takim me NJSBC;] NJSBC u shpreh se kur ka pasur ankimime ato janë trajtuar.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është struktura përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore në KUB. [dok DVV Evidencia nr. 44: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së, neni 11] Sipas {dok DVV Evidencia nr. 44: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së, neni 18} publikimi i rezultateve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të KU "Beder" është i detyrueshëm. Raportet vjetore të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të KU "Beder" dhe raporti i komisionit të vlerësimit dhe zhvillimit të cilësisë në arsimin e lartë publikohen në faqen e internetit.</p> <p>[https://www.beder.edu.al/sh/fcontent/default/raporti-vjetor--14-3/188/687]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin</p>	<p>KUB ka disa mekanizma vlerësimit për personelin akademik si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formulari i Anketave vetëvlerësuese të stafit akademik, plotësohet nga personeli akademik dhe kontrollohet nga përgjegjësi i departamentit përkatës. [dok DVV Evidencia nr. 41: Rregullore e anketave dhe



<p>akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>vlerësimeve, neni 3]</p> <ul style="list-style-type: none"> • Anketa vlerësuese e studentit për stafin akademik. Rezultatet e anketimeve dhe vlerësimeve i komunikohen çdo pedagogu në zarf të mbyllur. [dok DVV Evidenca nr. 41: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve, neni 14] <p>Sipas RVB, vlerësimi dhe promovimi i praktikave të mira bëhet nga eprorët në raportet vjetore të njësive të ndryshme akademike dhe administrative të institucionit dhe në takimet me personelin akademik dhe administrativ</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në KUB GVJ konstaton se personeli akademik i programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale. Syllabuset e lëndëve miratohen në department. [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Silabuset e lendeve; Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Gjatë vizitës në KUB GVJ konstatoi se personeli akademik i programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike merr në konsideratë nevojat e studentëve dhe bashkëpunon me ta për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie-mësimnxënie sa më të mirë. [Vizita në Institucion: Takimi me studentët; Takimi me stafin Akademik]. Personeli akademik ka ndjekur udhëzimin mbi mësimdhënien në distancë [dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzim mbi mësimdhënien në distance] dhe ka përshtatur format dhe metodat e mësimdhënies për t'ju përshtatur situatës së krijuar nga pandemia.</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>GVJ konstaton se KUB angazhohet për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit të tij akademik. Ai zhvillon trajnime me qëllim përmirësimin e kompetencave didaktike [dok DVV Evidenca nr. 45: Lista e trajnimeve për stafin; https://cmp.beder.edu.al/sh/news/activities/trajnim-ne-lidhje-me-perdorimin-e-google-classroom/1596;] GVJ pas vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit mundësojnë për personelin akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike. Mjediset ku zhvillohet mësimi i programit kanë rrjet kompjuterik profesional; akses per internet; tabela inteligjente; kompjutera; projektore;</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ pas analizimit të CV-ve të personelit akademik [dok DVV Silabuset e lendeve] konstaton se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike posedon përgatitje dhe kompetenca profesionale në mësimdhënie dhe në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Pjesë e personelit akademik të programit të studimit janë edhe individë me eksperiencë në biznes dhe administratë publike, me njohuri që lidhen dhe me kurrikulën e programit. Eksperiencia e tyre u shërben për të demonstruar në auditor raste reale të lidhura me fushën e studimit Shkenca Kompjuterike.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion [dok DVV Evidenca nr. 41: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve;], personeli akademik në KUB plotëson formularin e anketave vetëvlerësuese që kontrollohet nga përgjegjësi i departamentit përkatës. Gjithashtu rezultatet e anketimeve dhe vlerësimeve të anketës vlerësuese të studentit për stafin akademik, ku përfshihen dhe format dhe metodat e mësimdhënies, [dok DVV Evidenca nr. 42 Anketa e studentit ndaj lëndës; Evidenca nr. 43 Anketë, mësimdhënia në distancë] i komunikohen çdo pedagogu në zarf të mbyllur. Gjatë vizitës në KUB GVJ konstatoi se personeli akademik i programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike merr në konsideratë kërkesat e studentëve për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie-mësimnxënie sa më të mirë. Stafi akademik përditëson syllabuset në fillim të vitit akademik ku reflekton dhe përmirësimin e formave e metodave të mësimdhënies.[Vizita në institucion: Takim me studentët; Stafin Akademik të Programit;]</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Personeli akademik ofron ambiente online ose fizike që lejojnë interaktivitet duke i bërë tërheqëse orët e mësimi. [Vizita në institucion; dok DVV Silabuset e lendeve;] Ndër metodat dhe mjetet interaktive të përdorura nga stafi akademik janë smart board, projektion animacionesh, paraqitje fizike të pajisjeve,</p>

	inkurajimi i studentëve për të diskutuar rreth përmbajtjes apo dukurive të ndryshme të trajtuara në orët e mësimit, etj			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit dhe inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Ofrimi i ambienteve online ose fizike që lejojnë realizimin e laboratorëve detyrë, projekteve dhe punëve të ndryshme të pavarura inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit [Vizita në institucion; dok DVV Silabuset e lendeve;] Mësuesit janë të pranishëm gjatë laboratorëve detyrë, projekteve dhe punëve të ndryshme të pavarura të cilat realizohen pas përcjelljes së informacionit teorik nga ana e mësuesit. GVJ konstatoi respekt të ndërsjellë ndërmjet mësuesve dhe studentëve gjatë vizitave në institucion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësuesit dhe aftësinë profesionale duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	GVJ pas vizitave të hapësirave vlerëson se procesi mësimor e shkencor i programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike realizohet në hapësira të mjaftueshme, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. [Shenimet gjate vizites, Beder; dok DVV Evidenca nr. 47 Marrëveshje me kompaninë Albpastrim për mirëmbajtjen e ambienteve të KU "Bedër"] Bazuar në tabelën 16 të në ankesin e RVB [dok DVV RVB] hapësirat e vëna në dispozicion për procesin mësimor e shkencor të programit të studimit (Salla për leksione, Klasa për seminare, Salla për praktikë lëndore, profesionale, Laboratorë informatike, Salla internet, Salla për bibliotekë, Salle conference etj) zënë në total 1868.5 m ² . Ambientet shlodhëse, sportive dhe ato për aktivitetet e qeverisë studentore zënë në total 719 m ²
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të	GVJ pas vizitës në ambientet e dedikuara për procesin mësimor, [Vizita në Institucion] konstaton se ambientet janë të pajisura me sistem ngrohjeje, laboratorët mësimorë janë të pajisur me kompjutera dhe projektorë. Klasat janë të pajisura me videoprojektorë dhe me tabela inteligjente (smart board) të cilat bëjnë të mundur zhvillimin me cilësi të procesit mësimor.

procesit mësimor.	
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Personeli akademik dhe studentët e KUB përdorin sistemin IT të zhvilluar Beder Information System (BIS) [dok DVV Evidenca nr. 35 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)] Instucioni ka një marrëveshje me Google për përdorimin e platformën G-Suite [dok DVV Evidenca nr. 49 Marrëveshje me Google për platformën G-Suite] dhe akses online në bibliotekë JSTOR [dok DVV Evidenca nr. 48 Marrëveshje me librarinë Online JSTOR] GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton gjithashtu se personeli akademik dhe studentët e KUB përdorin infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për procesin mësimor: rrjet kompjuterik profesional; akses per internet tabela inteligjente; kompjutera; projektore; etj
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe e rekomanduar mbi të cilat organizohet dhe mbeshtetet procesi mësimor në programin Bachelor në Shkenca Kompjuterike garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme në fushën e shkencave kompjuterike. Duke qënë se programi i studimit Bachelor në shkenca kompjuterike formon specialist në një fushë në zhvillim shumë të shpejtë ka veshirësi në gjetjen e literaturës në gjuhën shqipe, literatura më e fundit për këtë program është kryesisht në gjuhë të huaj. Literatura është e ruajtur fizikisht në bibliotekë. Literatura në gjuhën angleze është në formë elektronike. Literatura e lëndës u jepte studentëve në formë elektronike që në leksionin e parë. [dok DVV Evidenca nr. 48 Marrëveshje me librarinë Online JSTOR; Vizita në institucion].
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	KU "Beder" disponon në bibliotekën fizike një numër të madh titujsh e botimesh. Biblioteka është e pajisur me tavolina, karrige, kompjutera, Wi-Fi dhe vihet në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës. Biblioteka e KU "Beder" ka kapacitet 24 poste leximi dhe 8 kompjutera në funksion të saj. Ne Bibliotekën fizike gjenden 22.600 tituj shkencor, 26.000 libra shkencor, 166 monografi shkencore dhe 48 revista shkencore [dok DVV RVB Aneks" Tabelat Përmbledhëse": Te dhena te plota per platformat on line Struktura e teknologjise se informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17); Vizita në Institucion]
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin	KU "Beder" në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies i ka ofruar personelit akademik dhe studentëve mundësinë e aksesimit në bibliotekën digjitale JSTOR. [dok DVV RVB RVB Aneks" Tabelat Përmbledhëse": Te dhena te plota per platformat on line Struktura e teknologjise se informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17); Evidenca nr. 48 Marrëveshje me librarinë Online JSTOR] Kjo librari aksesohet lehtësisht me

e studimit.	anë te llogarisë mail të institucionit.			
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ konstaton se për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike. Për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike të programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike, Kolegji Universitar "Beder" vë në dispozicion të studentëve dy labore informatike. [dok DVV RVB; Vizita në institucion]			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	KU "Beder" përdor platformën G-Suite për të ofruar shërbime kundrejt stafit dhe studentëve [dok DVV Evidenca nr. 49 Marrëveshje me Google për platformën G-Suite] . G-Suite siguroi vazhdimësi e pandërprerë të procesit mësimor gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Platforma G-Suite ofron ndër të tjera video-konferenca, klasa virtuale, prezantime, teste ose quize on-line, detyra dhe vlerësime për to etj.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Platforma G-Suite [dok DVV Evidenca nr. 49 Marrëveshje me Google për platformën G-Suite] që përdoret nga institucioni ofron ndër të tjera email dhe hapësirë pa limit drive duke mundësuar akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar për personelin akademik, administrative dhe studentët. Secili nga studentet në momentin e regjistrimit pajiset me një adresë emaili në formatin (iniciali i emrit, mbiemri, viti i regjistrimit @beder.edu.al) Stafit akademik dhe administrativ është i pajisur me adresë emailin në formatin (iniciali i emrit, mbiemri (@beder.edu.al). Nëpërmjet sistemit BIS menaxhohen të dhënat personale të stafit akademik, administrativ dhe studentëve.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se studentët e viti të tretë të programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike kanë zgjedhur provimin për përmbylljen e detyrimeve akademike. Sipas [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e Programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike, neni 19] bërja e një punimi të detyrueshëm të diplomimit nga ana e studentit, në përputhje me programin e arsimimit, i cili tregon arritjen e një niveli profesional të dëshiruar, vendoset nga ana e organeve kompetente të njësive përkatëse akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) në KUB organizon dhe drejton përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional [dok DVV Evidenca nr. 44 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së;] Në këtë rregullore përcaktohet edhe mënyra e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë kryesore dhe bazë. Rezultatet e pyetësorit, të paraqitura të përmbledhura në raport dhe që i komunikohen individualisht personelit akademik, shërbejnë si bazë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Stafi akademik plotëson formularin e vetëvlerësimit [dok DVV Evidenca nr. 50 Formulari i vetëvlerësimit për stafin akademik], i cili dorëzohet në njësinë bazë, përpara se të vlerësohen më tej nga eprorët e tyre. Bazuar në rregulloren e anketave dhe vlerësimeve [dok DVV Evidenca nr. 41 Rregullore e anketave dhe vlerësimeve] në procesin e vetëvlerësimit marrin pjesë I vlerësuarit (stafi akademik) dhe përgjegjësi i departamentit/vlerësuesi. Në këtë rregullore përcaktohen hapat që ndiqen në procesin e vetëvlerësimit. Njësia bazë, Departamenti i Shkencave Kompjuterike, është në monitorim të cilësisë për lëndët e ofruara nga programi edhe nëpërmjet anketës së lëndëve që plotësohet nga studentët [dok DVV Evidenca nr. 42: Anketa e studentit ndaj lende; Evidenca nr. 43 Anketë, mësimdhënia në distancë] Kjo anketë mundëson gjithashtu rritjen e vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në mësimdhënie.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	KUB inkurajon bashkëpunimin dhe ndarjen e eksperiencës së personelit të tij akademik dhe jo vetëm. [dok DVV Evidenca nr. 45 Lista e trajnimeve për stafin; Evidenca nr. 52 Lista e trajnimeve për kerkimin shkencor] Ndër këto trajnime mund të përmendim "Strategjitë e mësimdhënies", "The important tips for creating effective presentations and using new presentation applications; The using of smartboard and smartboard facilities", Teknologjia në ndihmë të mësimdhënies cilësore në universitet. Duke pasur eksperiencë në ofrimin e programeve të edukimit dhe komunikimit [dok DVV Evidenca nr. 28 Organigrama e

	<p>Kolegjit Universitar Bedër] dhe teknologjinë që ofrohet në ndihmë të procesit mësimor ka qënë i mundur eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja inovative të mësimdhënies. Mund të përmendim këtu mësimin ndërveprues, përdorimin e teknologjisë në funksion të mësimdhënies (tabelat inteligjente, aplikacionet e reja për prezantim, simulimet etj).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton se KUB mbështet kualifikimin në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor dhe implementimit të metodave të reja. Nga data 9 shtator 2019 deri në datën 30 shtator 2019, çdo të premte, në orën 10:00, ndër trajnime të tjera KUB ka organizuar trajnimin “Kërkimi shkencor si domosdoshmëri akademike” nga (Dr. William Karl Martin) [dok DVV Evidenca nr. 52 Lista e trajnimeve per kerkimin shkencor]. Ndër trajnime të tjera KUB ka organizuar trajnimet “Teknologjia në ndihmë të mësimdhënies cilësore në universitet” nga (Dr. Sofokli Garo) dhe “Përditësimi i sylabuseve si nevojë në vijueshmëri nga (Dr. Ferdinand Xhaferaj) [dok DVV Evidenca nr. 52 Lista e trajnimeve per kerkimin shkencor]</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik i programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike ka realizuar me sukses programin e studimit. [dok DVV Evidenca nr. 26 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2020-2021;] Ata angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies duke marrë pjesë në trajnime të organizuar nga institucioni. Personeli akademik angazhohet për implementimin e metodave të reja. [Vizita në institucion; dok DVV Evidenca nr. 52 Lista e trajnimeve per kerkimin shkencor: modulet e trajnimit “Teknologjia në ndihmë të mësimdhënies cilësore në universitet” nga (Dr. Sofokli Garo) dhe “Përditësimi i sylabuseve si nevojë në vijueshmëri nga (Dr. Ferdinand Xhaferaj.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>KUB organizon herë pas here trajnime për personelin akademik dhe personelin ndihmës akademik për metodat e reja në mësimdhënie [dok DVV Evidenca nr. 45 Lista e trajnimeve për stafin; Evidenca nr. 52 Lista e trajnimeve per kerkimin shkencor]. Sipas RVB, pas marrjes së trajnimeve të përvitshme për stafin, fillon aplikimi i metodave të reja dhe rezultatet e pritshmëritë diskutohen në mbledhjet e departamentit.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, janë të përcaktuara në rregulloren themelore të KU "Beder" dhe rregulloren e programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike [dok DVV Evidenca nr. 17 Rregullorja Themelore; dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e Programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike]. Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve [dok DVV Silabuset e lendeve;] të cilat u bëhen të njohura studentëve nëpërmjet sistemit BIS .			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga RVB dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se syllabuset e lendeve ruhen nga titullari i lëndës/modulit në sistemin BIS dhe student mund t'i shohin ato pas logimit në sistem, ku mund të marrin informacion mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Keto informacione ju komunikohen gjithashtu studentëve ne fillim të semestrit nga pedagogu i lëndës. [Vizita në Institucion] Syllabuset e lëndëve janë gjithashtu të publikuara në Website-in e Kolegjit Universitar Bedër. [https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-shkenca-kompjuterike-2-10/616/647]			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë: Provimi i ndermjetem, Niveli i pjesëmarrjes ne seminare, Detyra e kursit (projekte), Quize, Provimi perfundimtar. [dok DVV Evidenca nr. 17: Rregullorja Themelore, neni 100;dok DVV Silabuset e lendeve;]			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	GVJ konstaton se në rregulloren e KUB [dok DVV Evidenca nr. 17: Rregullorja Themelore, neni 78, pika 5] është përcaktuar se 'Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e provimeve semestrale/vjetore; pjesmarrjes; detyrave të kursit; prezantimeve; aktivizimeve dhe projekteve.' Vlerësimi i lëndës bëhet sipas modaliteteve të përcaktuara për të në syllabusin e saj. [dok DVV Silabuset e lendeve;]
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Bazuar në [dok DVV Evidenca nr. 39 Udhëzim mbi mësimdhënien në distance] forma kryesore e testimit elektronik gjatë mësimdhënies në distance është Google Forms. Kjo formë testimi u përdor gjatë periudhës së pandemisë. Nëpërmjet Google Forms testi mund të realizohet me alternativa dhe vlerësimi i studentit të bëhet në mënyrë automatike nga sistemi. Secili nga studentët mund të marrë në mënyrë individual tezen dhe automatikisht vlerësimin e tij, bashkë me çelësin e pergjigjeve. KU "Beder" disponon gjithashtu sistemin e brendshëm BIS ku bëhet komunikimi individualisht dhe ruajtja e vlerësimeve të studentit sipas lëndëve përkatëse.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në dokumentin [dok DVV Evidenca nr. 53 Shembull, organizimi i provimeve finale] KU "Beder" realizon testimin e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale me anëtarë të departamentit ku njëri prej tyre është titullari i lëndës ose modulit. Sipas [dok DVV RVB] testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në KU "Beder" realizohet nga titullari i lëndës ose modulit, si dhe asistenti të lëndës ose modulit, sipas rastit, dhe nga anëtarë të tjerë të stafit akademik të departamentit.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Në dokumentin e dorëzuar nga institucioni ku përcaktohen rregullat për organizimin e provimeve [dok DVV Evidenca nr. 54 Rregulla për organizimin e provimeve] nuk përcaktohet me detyrim zhvillimi në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim i provimeve. Gjatë vizitës në institucion u theksua se disa nga pedagogët e zhvillojnë provimin në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim të provimeve. Testimi i vlerësimit të njohurive, bëhet në ambiente të cilat vëzhgohen gjithmone nga së paku dy lektorë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës, ndërsa të tjerët anëtarë të stafit akademik të departamentit. <i>GVJ rekomandon vendosjen në rregullore të zhvillimit në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim të testimeve të vlerësimit të</i>

	<i>njohurive, dijeve me shkrim.</i>
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Sipas RVB [dok DVV RVB] vlerësimi i komponentëve të vlerësimit shoqërohet me komente dhe feedback nga pedagogu. Në të qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin dhe cilësinë e punimeve të tyre. Shpallja e rezultateve shoqërohet me shpjegimet përkatëse të përgjigjeve të sakta dhe me çelësin e tezës së provimit. Nga vizita në KUB dhe RVB në rastet e nevojshme, lektori është i gatshëm të bëjë sqarimet e nevojshme për studentët që e kërkojnë këtë.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Bazuar në dokumentacion [dok DVV Evidenca nr. 54 Rregulla per organizimin e provimeve; Evidenca nr. 55 Rregullorja per disiplinën e studentëve;] GVJ konstaton se kopjimi në provime është i patolerueshëm. Sipas RVB [dok DVV RVB] të gjitha detyrat e kursit dhe projektet kontrollohen për plagjiaturë me anë të platformave falas dhe pa pagesë. Testet e ndërmjetme dhe ai final administrohen nga prania në auditor e dy pedagogëve, të cilët janë përgjegjës për moslejimin e kopjimit.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ konstaton se në rregullorene e departamentit [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e Programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike] thuhet shprehimisht “Gjendja e suksesit të çdo lënde u dorëzohet organeve administrative përkatëse, brenda afatit të përcaktuar në kalendarin akademik dhe rezultatet publikohen në faqen personale të studentëve në BIS. Sipas RVB [dok DVV RVB] matja e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale është objektiv dhe punët dhe projektet individuale ose në grup vlerësohen duke u bazuar në meritë.
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Bazuar në në rregullorene e departamentit [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e Programit Bachelor ne Shkenca Kompjute, Neni 27 Ankimimi ndaj rezultateve të provimeve] në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve, të paraqesë një ankesë me shkrim te zyra e sekretarisë mësimore
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Bazuar në në rregullorene e departamentit [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e Programit Bachelor ne Shkenca Kompjute, Neni 27 Ankimimi ndaj rezultateve të provimeve] ankimi shqyrtohet mbi gabimet materiale, nga një komision i cili ngrihet me vendim të Këshillit të Departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre vetash. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Sipas RVB,

	kjo procedurë dokumentohet dhe arkivohet pranë departamentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Misioni dhe vizioni i programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike, përcakton se ky program ka si qëllim formimin e ekspertëve dhe specialistëve në nivel cilësor në fushën e shkencave kompjuterike. [https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-shkenca-kompjuterike-2-10/616/647] Bazuar në kurrikulën e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe në syllabus-et e lëndëve të veçanta, GVJ konstaton se programi synon zhvillimin e dijeve të studentëve dhe avancimin e tyre teknik e profesional në fushën e shkencave kompjuterike. [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Silabuset e lendeve;]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike zhvillon aftësi të veçanta në fushën e shkencave kompjuterike. [dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; dok DVV Silabuset e lendeve;] Kurrikulat dhe syllabuset përditësohen sipas kërkesave të kohës duke përfshirë teknologjitë më të fundit. [dok DVV Silabuset e lendeve] Në kurrikulën e programit janë parashikuar mësimi i gjuhës angleze dhe metodave kërkimore dhe shkrimit akademik.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Sipas RVB [dok DVV RVB], në përfundim të semestrit, lektori i lëndës sigurohet me anë të metodologjive të ndryshme vlerësuese të aplikuara nga ana e tij që objektivat e shprehura në syllabuset e lëndëve, të jenë arritur dhe plotësuar. Këto trajtohen në diskutim të lire me studentët ku secila prej palëve paraqet konkluzionet përkatëse për njohuritë dhe shprehjet e fituara duke nxjerrë dhe konkluzionet e nevojshme për nevojat e përmirësimit të vazhdueshëm të procesit.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në	Gjatë vizitës në institucion [Vizita në institucion] stafi akademik u shpreh se studentët, nën monitorimin e lektorëve dhe asistentëve të lëndës, realizojnë projekte individuale kreative ku përfshihet vënia në

<p>pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>praktikë e çështjeve më të rëndësishme të lëndës. Sipas RVB [dok DVV RVB], në departamentin e Shkencave Kompjuterike organizohen workshope demo për të demonstruar punët e studentëve.</p> <p>Studentët marrin udhëzime konkrete nga stafi akademik për format e implemetimit të njohurive dhe aftësive të fituara në lëndë të ndryshme duke i orientuar ata për praktika profesionale në kompani apo institucione të ndryshme. Disa nga institucionet në të cilat janë organizuar praktika profesionale janë AKCESK, Robustek, Big Media Expert. [dok DVV Evidenca nr. 26 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2020-2021] Gjatë vizitës në institucion u përmend gjithashtu bashkëpunimi dhe me kompaninë ATOM Computers për realizimin praktikave. [Vizita në Institucion] Ndër profilet kryesore në të cilat janë realizuar praktikat profesionale përmendim: Siguri te dhënash, Inteligjenca artificiale, Virtual Reality, Software Development, Front End Developer etj. Angazhimi i studentëve në praktikat profesionale dhe vlerësimi I tyre nga ana e mbikqyrësve të praktikave profesionale ka qenë shumë i kënaqshëm. [dok DVV Evidenca nr. 26 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. Për vitin 2020-2021, departamenti i Shkencave Kompjuterike ka hartuar një plan aktivitetesh, ndër të cilat bëjnë pjesë edhe leksione dhe seminare jashtë strukturës së programit të studimit [dok DVV Evidenca nr. 21 Vendim i Këshillit të Departamentit për miratimin e planit të aktiviteteve, viti akademik 2020-2021] Në këto aktivitete janë zhvilluar edhe webinarë online apo seanca demonstruese mbi aplikime teknologjike. Ndër to mund të përmendim ” Zhvillime teknologjike në biznes në tregun shqiptar” në të cilin prezantuan përfaqësues të kompanive të ndryshme si: “S&T Albania” që trajtoi brandet kryesore në ofrimin e shërbimeve Computing Data Storage, dhe Data Security si dhe mënyrës se si mund të bëhesh partner me këto brande si dhe nevojat e tregut për specialist të këtyre brandeve.; Novotek (Hikvision and Mikrotik Partner) që trajtoi komponentët kryesorë të sistemeve të sigurisë, aksesin remote, aksesin dhe njoftimet e automatizuar, integrimin e sistemeve të zjarrit, alarmit dhe kamerave në dedektimin dhe menaxhimin më të mirë të problematikave që mund të hasen me këto sisteme; ATOM Computers që trajtoi rëndësinë e çertifikimeve të IT dhe në përfitimet e shumta që sjellin këto çertifikime si në zhvillimin profesional po ashtu edhe në zhvillimin e një karriere të qëndrueshme; Një tjetër leksion i hapur është “Hap tjetër në Teknologji. Hyrje në Virtual & Augmented Reality”. i mbajtur nga MSc. Ferit Melih Akaybicen. Disa nga temat që u trajtuan në këtë leksion janë: Çfarë është Virtual Reality?; Historia</p>

	e Virtual Reality; Unreal Engine 4; Oculus Quest; Çfarë është Augmented Reality?; Augmented kundrejt Virtual Reality; Hololens etj [dok DVV Evidenca nr. 26 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2020-2021]
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale:	GVJ konstaton se gjatë zhvillimit të orëve mësimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi dhe projekte të ndryshme në fushën e shkencave kompjuterike. GVJ gjithashtu vlerëson se personeli akademik i programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer ekspertiza laboratorike së bashku me studentët. Studentët aplikojnë njohuritë e marra gjatë lëndëve në praktikat profesionale [dok DVV Evidenca nr. 26 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2020-2021]
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në institucion, personeli akademik i programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyra e kursit në lëndët përkatëse është një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup. Pergjithësisht temat e detyrave të kursit janë raste studimi reale, në të cilat personeli akademik nxit studentët që ta trajtojnë studimin dhe ofrimin e zgjidhjes së problemeve duke u organizuar në skuadër. [dok DVV Silabuset e lendeve; Vizita në Institucion]
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Detyrat e kursit pjesë e programeve mësimore të lëndëve në programin Bachelor në Shkenca Kompjuterike krijojnë klimë të përshtatshme për mbështetjen dhe zhvillimin e ideve inovative. [dok DVV Silabuset e lendeve; Vizita në Institucion]
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	GVJ konstaton se në planin strategjik të KUB [dok DVV Evidenca nr. 12 Plani Strategjik 2018-2023] një zë të veçantë ka rritja e mundësive dhe e përvojave ndërkombëtare për studentët duke synuar kështu rritjen e vetëdijes kulturore të studentëve dhe duke mbështetur idetë inovative profesionale dhe kërkimore shkencore. Ndër nismat për konkretizim të objektivit strategjik "Rritja e mbështetjes së studentëve nga strukturat institucionale në veprimtarinë akademike dhe aftësimin për tregun e punës" në këtë plan është: Të stimulohen studentët për të marrë pjesë në konferenca studentore dhe projekte të ndryshme kërkimore. Kolegji Universitar "Bedër" ka ngritur Qendrën për kërkuesit e rinj. [dok DVV Evidenca nr. 75 Raporti vjetor institucional 2020-2021] Qendra ka për qëllim t'u ofrojë studentëve

	një mundësi për të qenë pjesë e veprimtarisë kërkimore të institucionit, si dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në fushën e kërkimit shkencor. Qendra e Kërkuesve të Rinj shërben si një mundësi për të gjithë pjesëmarrësit për propozimin e iniciativave kërkimore-shkencore. Pas trajnimit të studentëve lidhur me metodat kërkimore dhe hartimin e projekteve, qendra ka organizuar konkursin e parë për propozimet e projekteve kërkimore. Planifikimi është që projektet fituese të financohen nga Kolegji Universitar “Bedër” ose të paraqiten pranë institucioneve donatore.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ konstaton se [dok DVV Evidenca nr. 25 Lista e bashkëpunimeve dhe MOU] se KUB ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e TorVergata ne Itali me fokus shkëmbimin e eksperiencave akdemike dhe mbështetjen e shkëmbimeve të lektorëve dhe të studentëve. Sipas RVB [dok DVV RVB], janë ndërtuar ura ndërlidhëse komunikimi dhe bashkëpunimi me këtë universitet për të mundësuar mobilitetin e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në Rregulloren Themelore të KUB [dok DVV Evidenca nr. 17 Rregullorja Themelore;] përcaktohet se studentët mund të diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome, në varësi të pragut të notës mesatare. Bërja e një punimi të detyrueshëm të diplomimit nga ana e studentit në përputhje me programin e arsimimit, i cili tregon arritjen e një niveli profesional të dëshiruar, vendoset nga ana e organeve kompetente të njëjësive përkatëse akademike. Kushtet e kryerjes së punimit, afati i dorëzimit, provimi dhe vlerësimi i punimit përcaktohet nga këto organe. Punimi i diplomimit përfshihet si lëndë e semestrit të gjashtë në programet e ciklit të parë. Programi i ciklit të parë Bachelor në Shkenca Kompjuterike këtë vit akademik nxjerr të diplomuarit e parë.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion	KUB ka hartuar një manual për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë [dok DVV Evidenca nr. 57 Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë]

<p>informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Sipas Rregullores themelore të KUB, [dok DVV Evidenca nr. 17 Rregullorja Themelore; neni 88] punimi i diplomimit përfshihet si lëndë e semestrit të gjashtë në programet e ciklit të parë. Programi i ciklit të parë Bachelor në Shkenca Kompjuterike në Kolegjin Universitar Bedër këtë vit akademik nxjerr të diplomuarit e parë. Sipas RVB, Kolegji Universitar "Beder" ben të mundur berjen publike te informacioneve rreth provimeve finale ose mbrojtjes se diplomave sipas rregullores. Udheheqesit e diplomave jane aktoret kyç ne percjelljen e këtij informacioni.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Programi i ciklit të parë Bachelor në Shkenca Kompjuterike në Kolegjin Universitar Bedër këtë vit akademik nxjerr të diplomuarit e parë. Akoma nuk është zhvilluar dhe administruar provim final për këtë program studimi. Sipas RVB, një komisioni i posaçëm, harton provimin (nëse punimi i diplomës nuk është një opsion) ku përfshihen njohuri nga të gjitha lëndët e programit bachelor në Shkenca Kompjuterike, duke vënë më tepër rëndësi mbi ato pyetje që kanë më shumë peshë në formimin akademik ose profesional të studentit. Provimi zhvillohet në bazë të rregullave të përcaktuara në dokumentin “Rregulla për organizimin e provimeve” [dok DVV Evidenca nr. 54 Rregulla per organizimin e provimeve]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike përcakton stafin akademik për udhëheqjen e diplomave apo provimin final [dok DVV Evidenca nr. 58 Parashikimi i ngarkesës mësimore për semestrin e pranverës, Departamenti i Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2020-2021]. Ata kanë për detyrë dhe rol të rëndësishëm në orientimin dhe përgatitjen e studentëve në prag diplomimi.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Sipas RVB, përgjegjësia kryesore për mbikëqyrjen dhe udhëzimin e studentëve gjatë procesit të përgatitjes së punimit të diplomës është e udhëheqesit, të cilët përcaktohen nga departamenti. [dok DVV Evidenca nr. 58 Parashikimi i ngarkesës mësimore për semestrin e pranverës, Departamenti i Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2020-2021.] Caktimi i udhëheqësve akademike nga KU "Beder", përfshin edhe asistencën e tyre në analiza, teste, matje, etj, në fushën e punimit të temës së diplomës.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose</p>	<p>KUB ka një udhëzues të miratuar për shkrimin e temës [dok DVV Evidenca nr. 57 Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë]. Sipas RVB, caktimi i udhëheqësve akademike nga KU "Beder", përfshin edhe asistencën e tyre në analiza, teste, matje, shkrimin e temës, në fushën e punimit të temës së diplomës si dhe garantimin e cilësisë së rezultateve dhe miratimin ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. Ky është brezi i parë i</p>

jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	studentëve që diplomohen në këtë program në KUB. Gajtë vizitës në institucion GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se studentët që diplomohen këtë vit nuk kanë zgjedhur temë diplome.			
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Sipas rregullores themelore të KUB dhe planit mësimor të programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike për këtë vit akademik. [dok DVV Evidenca nr. 17 Rregullorja Themelore; Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike] punimi apo provimi i diplomimit përfshihet si lëndë e semestrit të gjashtë dhe si e tillë vlerësohet me notë.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	KUB, në përfundim të studimeve, pajis studentin me diplomën dhe suplementin formati i të cilave për programin Bachelor në Shkenca Kompjuterike paraqitet në dokumentin [dok DVV Evidenca nr. 61 Diploma dhe Suplementi]			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	KUB vë në dispozicion kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar sipas kërkesës së studentëve. Një shembull i përshkrimit të lëndëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore jepet në [dok DVV Evidenca nr. 62 Shembull, pershkrim lendesh nga Zyra e Sekretarise Mesimore]			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	GVJ konstaton se, KUB përcakton në rregulloren e arkivës [dok DVV Evidenca nr. 63: Rregullorja e Arkives, neni 6] ruajtjen për një periudhë të pacaktuar të një kopje të dokumentacionit të studentit. Gjatë vizitës në KUB sekretaria i paraqiti GVJ informacion mbi student të programit Bachelor në Shkenca Kompjuterike të zgjedhur random nga GVJ.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit,


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

vlerësimi dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	Kolegji Universitar Beder – KUB me ane te zyrës se burimeve njerezore mbledh dhe ruan të dhëna të sakta për personelin akademik dhe ndihmës akademik duke përfshirë ngarkesën mësimore dhe detyrat e stafit të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike. Po ashtu në fund të çdo fillim semestri, nga njësia baze bëhet planifikimi i ngarkesës mësimore dhe personelit PAE+PAK dhe me pas miratohet nga dekanati . Të dhënat për PAE dhe PAK, ngarkesa totale në semestra si edhe informacioni mbi personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, ruhen në forme fizike dhe ne nje baze te dhenash dhe po ashtu depozitohen pranë Zyrës se Burimeve Njerëzore. [Ev. nr. 58 Parashikimi i ngarkesës mesimore per semestrin e pranverës, DSHK, viti akademik 2020-2021] [Aneks i RVB Tabelat Permbledhese]
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	KUB, në përputhje me nevojat për staf akademik shpall vakancat dhe bën përzgjedhjen e stafit në bazë të kriterëve ligjore të punësimit të përcaktuara nga statuti si edhe rregulloret përkatëse. Pas aplikimit nga ana e kandidateve, përzgjedhja bëhet nga nje komision ad-hoc sipas procedurave përkatëse deri ne emërimin e punonjësit akademik. [Ev. nr. 65 – Procedura e punësimit te stafit] [Ev. nr. 66 – Shembull Kriteret per vendet vakante]
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriterëve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Me ane te dokumentacionit përkatës, KUB ben shpalljen për rekrutimin e stafit akademik duke cilësuar kriteret e përgjithshme dhe ato specifike duke ja vene në dispozicion edhe kandidateve. Dokumentet jane gjithëpërfshirës dhe ne to përcaktohen hapat që ndiqen për rekrutim si edhe anekset përkatëse në funksion të plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm. Shpallja me kriteret përkatëse, behet publike ne websiten e institucionit ose duke e dërguar ate pranë zyrës se punës. [Ev. nr. 10 – Statuti i KU Beder Kreu XV Personeli akademik] [Ev. nr. 66 – Shembull Kriteret per vendet vakante] [Ev. nr. 65 – Procedura e punësimit te stafit] [https://www.beder.edu.al/sh/content/default/vende-te-lira-pune-13/411/656]
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe	Procedurat e rekrutimit te stafit akademik ne KUB janë të detajuara duke përfshirë jo vetëm kriteret profesionale por edhe elemente të tjerë që garantojnë përzgjedhjen e personelit të përshtatshëm me ambientin akademik të institucionit. Nder



<p>specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>kriteret e specifike që propozohen nga njësia baze janë fusha e studimit, profili i specializimit si edhe eksperiencia profesionale e cila synon gërshetimin e njohurive teorike me të praktike. Sikurse u përmend me lart, të gjitha këto kritere behen publike për kandidatet e interesuar. Duke pasur parasysh profilizimin e stafit që mbulon programin e studimit Bachelor në Shkencat Kompjuterike, GVJ konstaton se duhet të synohet rekrutimi me prioritet i stafit PAE me profil në Shkencat Kompjuterike apo IT megjithë vështirësitë për rekrutime të kandidateve të kualifikuar në këto profile për shkak të kërkesës së madhe të tregut të punës.</p> <p>[Ev. nr. 65 – Procedura e punësimit të stafit][Vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik] [Shtojcë : CV e stafit akademik]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efektive dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Kolegji Universitar Beder ofron një infrastrukturë të përshtatshme me mjedise komode dhe të bollshme për stafin akademik duke vënë në dispozicion ambientet e punës dhe mjetet teknologjike të nevojshme për kryerjen e detyrave të personelit. Përmes programeve të trajnimit të vazhdueshëm synohet të rritet kualifikimi i stafit akademik. Personeli midis të tjerash ka në dispozicion laboratorët dhe bibliotekën për zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe asaj shkencore.</p> <p>[Ev. nr. 45: Lista e trajnimeve për stafin 2014-2020] [Ev. nr. 52: Lista e trajnimeve për kërkimin shkencor][Ev. nr. 67: Plan vjetor trajnimesh të personelit]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni i kushton një rëndësi të veçantë investimit në personel me anë të trajnimeve apo kualifikimeve në kuadër edhe të bashkëpunimit në projektet ndërkombëtare. Trajnimet planifikohen nga instancat e KUB si Burimet Njerezore dhe NJSBC duke i dhënë mundësinë personelit akademik për një integrim me të shpejta në proceset akademike dhe kërkimore duke synuar vazhdimisht rritjen e cilësisë. Në mënyrë me specifike, këto trajnime lidhen me apsekte të njohjes me kuadrin</p>

	<p>ligjor, me zhvillimin e aftësive menaxheriale dhe atyre administrative si edhe me mjetete e kerkimit shkencor duke qene ne përputhje me nevojat e tregut te punës dhe kërkesave te studenteve. Trajnimet mbi çështjet e mësipërme janë kryer ne periudhën midis viteve 2018 dhe 2021. GVJ ka konstatuar po ashtu se nje pjese e stafit vijnë nga kompanitë qe operojne ne tregun e IT duke sjelle eksperiencën e tyre ne drejtim te përmbushjes se anës praktike te programit te studimit.</p> <p>[Ev. nr. 67: Plan vjetor trajnimesh te pesonelit] [Vizita ne institucion dhe takimi me stafin akademik]</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Programet trajnuese ne lidhje me zhvillimet teknologjike jane nje pjese e rëndësishme e strategjisë se KUB per përditësimin e stafit mbi metodat bashkekohore te mësimdhënies dhe ato kerkimore shkencore. Trajnimi online i koordinuar me tutoriale ne fushën e IT, ka sjelle nje harmonizim me te mire te platformave elektronike si Google classroom, Zoom etj. Trajnimet ndahen në faza për tju përshtatur me mire aspektit të kualifikimit. [Ev. nr. 49: Marreveshje me Google per platformën G-Suite] [Ev. nr. 67: Plan vjetor trajnimesh te pesonelit]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Megjithë vështirësitë e njohura për angazhimin e stafit akademik në fushën e shkencave kompjuterike, KUB ndjek strategji që synojnë rekrutimin e stafit profesionist me eksperience jo vetëm në fushën akademike teorike por edhe atë aplikative. Nje pjese e stafit akademik PAK vjen nga kompanitë e njohura duke sjelle eksperiencën e tyre per zbatimin e aspekteve teorike ne praktike. Përfshirja e keshilltareve akademike per orientimin e studenteve ne përzgjedhjen e lendeve, lehtëson koordinimin e aktiviteteve të stafit me njësitë e tjera bashkëpunuese të universitetit në funksion të përmbushjes së objektivave të programit te studimit.</p> <p>[Vizita ne institucion dhe takimi me stafin akademik] [Ev. nr. 23: Vendimi i këshillit te departamentit per caktimin e këshilltarit akademik]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për

formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>KUB ofron ambiente të përshtatshme dhe të bollshme si klasa për zhvillimin e mësimin apo laboratorë mësimorë në përputhje edhe me natyrën aplikative të programit të studimit të Shkencave Kompjuterike. Zhvillimi i mësimin behet me grupe të vogla studentesh duke u përshtatur më së mire në ambientet dhe infrastrukturën aktuale. Përveç klasave dhe laboratorëve, mjedise të tjera edhe jashtë godinave, janë vënë në dispozicion të studenteve duke qënë një mundësi çlodhje gjatë kohës së lire. Institucioni kujdeset po ashtu edhe për mirëmbajtjen e tyre duke kontaktuar kompani të posaçme.</p> <p>[Vizita e GVJ në institucion][Shtojca në RVB: Mjediset e fakultetit/Njesive baze, Tabela 16] [Ev. nr. 47: Marreveshje me kompaninë Albpastrim për mirëmbajtjen e ambienteve të KU Beder]</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Duke pasur parasysh natyrën e programit të studimit, institucioni e konsideron të rëndësishme bazën laboratorike të përshtatshme si edhe dixhitalizimin e ambienteve mësimore në funksion të një procesi akademik sa më cilësor. Nga vizita e GVJ në institucion u konstatua se ambientet mësimore ishin të pajisura me projektorë, kompjutera, printera dhe tabela interaktive të cilët mundësonin zhvillimin e mësimin duke përdorur metoda bashkëkohore ndërveprimi me studentet. Pajisjet elektronike përdoren edhe në koordinim me departamentet e tjera si ai i Shkencave të Komunikimit.</p> <p>[Vizita e GVJ në institucion][Shtojca në RVB: Mjediset e fakultetit/Njesive baze, Tabela 16]</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Duke pasur parasysh natyrën aplikative të programit të studimit të Shkencave Kompjuterike, institucioni ka pajisur ambientet me mjetet e nevojshme elektronike për tju mundësuar studenteve gërshetimin e njohurive teorike me ato praktike si edhe duke ju dhënë mundësinë të aplikojnë këto njohuri në zgjidhjen e detyrave dhe problemeve reale. GVJ vizitoi mjediset laboratorike dhe konstatoi se ato përmbanin pajisjet e nevojshme për të zhvilluar punët praktike sidomos në fushat e programimit apo ato të medias. Edhe mjediset e tjera ishin të përshtatshme në funksion të zhvillimit të aktiviteteve akademike dhe sociale. [Vizita e GVJ në institucion][Shtojca në RVB: Mjediset e fakultetit/Njesive baze, Tabela 16][Takimi i GVJ me studentët e programit të studimit SHK]</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>KU Beder ka ne dispozicion dy laboratorë Informatike të pajisur me kompjutera bashkëkohore (hardware), si edhe me programet përkatëse që i nevojiten programit të Shkencave Kompjuterike. Këta laboratorë vihen në dispozicion të studenteve edhe gjate kohës së lire duke plotësuar nevojat e tyre. [Vizita e GVJ ne institucion] [Shtojca ne RVB: Mjediset e fakultetit/Njesive baze, Tabela 16] [Ev. nr. 68: Specifikime Teknike per laboratorin e kompjuterave]</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Institucioni përveç kapaciteteve aktuale, ka lidhur një sërë marrëveshjesh me institucione te ndryshme dhe kompani që operojnë në fushën e Informatikes me qëllim të zhvillimit të praktikave profesionale, si një ndër komponentët më të rëndësishëm në formimin praktik të studenteve. Nje pjese e bashkëpunimeve eshte realizuar ne formën e memorandumeve te mirëkuptimit ku synohet qe institucionet partnere te ofrojne trajnime dhe mbështetje per praktika mesimore dhe profesionale. Nder këto 67 instucione mund te përmendim universitete brenda dhe jashtë vendit, ministri, bashki, shkolla e magjistraturës, këshilli Britanik (British Council) etj. Nder kompanitë me bashkëpunim te ngushte eshte “Atom Computers” ne Tirane ku studentet mund te kryejne praktika profesionale, trajnime profesionale per studentet si edhe trajnime te stafit. Shfrytëzimi i infrastrukturës së tyre ju jep mundësinë studenteve që të familjarizohen edhe me një ambient real të punës. Bashkëpunimi me kompanitë partnere lidhet po ashtu me mundësitë për punësim të të diplomuarve të ardhshëm dhe per kete qellim pranë departamentit te SHK eshte caktuar nje përfaqësues me zyrën e planifikimit te karrierës. Sic edhe eshte theksuar me herët, ne stafin PAK jane rekrutuar persona me eksperince ne kompanitë e biznesit qe operojnë ne fushën e Informatikes.</p> <p>[Vizita e GVJ ne institucion - Takimi i GVJ me studentët e programit të studimit SHK] [Ev. nr. 25: Lista e bashkëpunimeve dhe MOU] [Ev. nr. 56: Formular aplikimi per zhvillimin e praktikës profesionale]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e

nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	KU Beder ju ofron studenteve dhe stafik akademik një bibliotekë me hapësira të mjaftueshme dhe komode, me literature në formë fizike dhe elektronike. Për këtë të fundit janë vendosur në dispozicion kompjutera që lejojnë akses në librarinë elektronike dhe në Internet. Biblioteka mund të shfrytëzohet lirshëm nga studentet në baze të një udhëzimi mbi funksionimin e bibliotekës. [Vizita e GVJ ne institucion] [Ev. nr. 38: Udhezimi mbi funksionimin e bibliotekes]
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka ka një seksion të veçantë për literaturën fizike në dispozicion të programit të Shkencave Kompjuterike. Literatura përbëhet nga libra, dispensa dhe materiale ndihmëse të shtypura sipas rekomandimeve nëpër syllabuset e lendeve. Duke pasur parasysh edhe natyrën specifike të fushës, biblioteka ofron po ashtu edhe literaturë në gjuhën angleze e cila synon të plotësojë mangësitë e ripërtëritjes në kohë të literaturës përkatëse në gjuhën shqipe. Ripërtëritja e materialeve në bibliotekë bëhet me kërkesë të studenteve apo stafit akademik sipas modaliteteve të përcaktuara për këto qëllime. [Vizita e GVJ ne institucion] [Ev. nr. 38: Udhezimi mbi funksionimin e bibliotekes]
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Përveç literaturës së shtypur, KU Beder ofron edhe akses në librarinë elektronike online siç janë JSTOR dhe Book academic Collection. Studentet dhe stafi akademik mund të shfrytëzojnë materialet në formë elektronike nga kompjuterat e vendosura në dispozicion. Aksesimi është i lirë për të gjithë studentet dhe i disponueshëm në çdo kohë. [Vizita e GVJ ne institucion] [Ev. nr. 38: Udhezimi mbi funksionimin e bibliotekes] [Ev. nr. 48: Marreveshje me librarinë online JSTOR]
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Kompjuterat e vendosur në sallën e bibliotekës, lejojnë studentët të aksesojnë direkt librarinë online dhe të gjitha materialet në formë elektronike të vendosura në dispozicion të studenteve. Çdo kompjuter është i pajisur me software-t përkatës në formën e “browserave” që mundësojnë ndërveprimin online me dokumentacionin dhe shfrytëzimin e efikas të tij. Për tju ardhur në ndihmë të studenteve, në faqen zyrtare të KUB është vendosur një link https://library.beder.edu.al/ që lejon aksesin direkt në bibliotekën online. Edhe në këto rast studentet mund të përdorin një “browser” google chrome apo MS Edge për të aksesuar direkt literaturën online. Libraritë online janë bërë tashmë

	standarte per kërkimin dhe shfrytëzimin e literaturës. [Vizita e GVJ ne institucion][Takimi i GVJ me studentët e programit të studimit SHK][https://library.beder.edu.al/]			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Duke pasur parasysh natyrën dinamike të programit të studimit në Shkencat Kompjuterike, KUB i jep mundësinë stafit dhe studenteve që të ripërterije fondin ekzistues ose ta pasuroje atë me ane të një fondi financiar të posaçëm të venë për këtë qëllim. Për shkak të zhvillimit të shpejtë të fushës, mjaft literatura ofrohen edhe në formë elektronike nga ana e stafit pasi ato konsiderohen më efektive në lidhje me përditësimin e temave të ndryshme. Pasurimi i bibliotekës është apo ashtu objekt i projekteve studentore dhe bashkëpunimit me institucione të ndryshme. [Vizita e GVJ ne institucion][Takimi i GVJ me studentët e programit të studimit SHK]			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është vendosur në shërbim të studenteve sipas orareve të përshtatshme për ta nga ora 08:00 deri në 19:00 gjatë ditëve të javës. Vetëm gjatë periudhës së provimeve ajo qëndron hapur edhe në fundjavë. Hapësira dhe komoditeti i saj i përshtaten kërkesave dhe nevojave të studenteve të cilët mund të përdorin edhe pajisjet e tyre kompjuterike për aksesin online në materialet e saj. [Vizita e GVJ ne institucion] [Ev. nr. 38: Udhezimi mbi funksionimin e bibliotekës] [Ev. nr. 48: Marreveshje me librarinë online JSTOR]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e	Institucioni ka në shfrytëzim sistemin e informacionit BIS (Beder Information Sistem) për të menaxhuar dhe administruar në mënyrë të shpejtë informacionet që lidhet me stafin dhe studentet e programit të Shkencave Kompjuterike. Nga ana e zyrës së IT çdo student pajiset me kredencialet përkatëse për të aksesuar këtë sistem përgjatë periudhës së studimeve deri në diplomim. Sistemi shërben edhe si një ambient komunikimi me stafin akademik, atë administrativ dhe të gjitha instancave të

studimit.	përfshira ne zbatimin e programit te studimit SHK. [Vizita e GVJ ne institucion] [Ev. nr. 35: Udhezues i sistemit te informativ Beder - BIS] [https://bis.beder.edu.al/]
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi BIS është një strukturë e automatizuar që gërsheton komunikimin midis stafit akademik dhe ndihmës akademik, studenteve, personelit administrativ, sekretarisë mesimore, zyrave të ndryshme etj. Të gjitha palët e përfshira në këtë sistem kanë akses në informacionin e ruajtur në të sipas roleve që ata kanë. Për tu familjarizuar me sistemin, është vene në dispozicion edhe udhëzuesi përkatës. [Vizita e GVJ ne institucion] [Ev. nr. 35: Udhezues i sistemit te informativ Beder - BIS]
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	BIS është një element shumë i rëndësishëm komunikimi dhe informimi për stafin akademik, administrativ si edhe studentet. Këta të fundit mund të marrin informacion në kohe reale mbi stafin, vlerësimet e vazhdueshme dhe ato përfundimtare, si edhe të aksesojne materiale si syllabuset, njoftime, oraret e provimeve etj. [Ev. nr. 35: Udhezues i sistemit te informativ Beder - BIS] [https://bis.beder.edu.al/]
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	BIS mundëson qe te dhënat e ruajtura ne te te qarkullojnë lehtësisht midis palëve te interesuara. Si stafi edhe studentet kanë mundësi të nxjerrin në çdo kohë informacione që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Si një sistem i integruar, mundëson një sërë funksionesh që shfrytëzohen nga të gjithë përdoruesit e regjistruar në të. Ndërveprimi behet me ane te nje nderfaqjeje te posacme ku cdo përdorues ka kredenciale te posacme aksesit. [Ev. nr. 35: Udhezues i sistemit te informativ Beder - BIS]; [https://bis.beder.edu.al/]
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Pervec funksionalitetit baze, BIS mundeson edhe gjenerimin e raporteve të ndryshme për të monitoruar dhe analizuar aktivitete akademike si edhe për të përgatitur të dhëna mbi procesin mesimor të cilat me pas ju përcillen organeve drejtuese. Këto raporte shërbejnë për të vlerësuar cilësinë e proceseve mësimore si edhe për të gjeneruar të dhëna statistikore. Raportet e nxjerra nga BIS përfshihen edhe në raportin vjetor të veprimtarisë se institucionit. [Ev. nr. 26: Raporti vjetor i departamentit te shkencave kompjuterike, viti akademik 2020-2021]
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e	KU Beder ofron nderfajqen ne web me ane te faqes zyrtare në Internet www.beder.edu.al në të cilën publikohen informacione të ndryshme mbi programet e studimit, organizimin akademik, inovacionin, aktivitetet akademike, kërkimin shkencor,

ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	infrastrukturën, regjistrimet e studenteve, kontaktet, njoftimet etj. Informacioni sipas përzgjedhjes jepet në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe përditësohet periodikisht sipas veprimtarive. [Vizita e GVJ ne institucion][Faqja zyrtare beder.edu.al]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	KU Beder ka statusin e nje IAL jofitimprurës dhe cdo vit hartohet nje një buxhet vjetor qe synon te permbushe objektivat e programit të studimit, duke marrë në konsideratë kostot dhe nevojat për burimet njerëzore akademike dhe jo-akademike, infrastrukturën etj. Donacionet po ashtu jane nje burim i konsiderueshëm per mbështetjen financiare te institucionit. Ne rastin konkret eshte paraqitur nje table me te ardhurat dhe financimet ku synohet nje mbështetje e plote per mbarëvajtjen e programeve te studimit, si edhe projekt buxheti afatmesëm deri ne vitin akademik 2023-2024. [Ev. nr. 1: VKM “Per licensimin e Shkolles se Larte “Hena e Plote” Beder] [Shtojca ne RVB: Te ardhurat dhe financimet ne 3 vitet e fundit, Tabela 18] [Ev. nr. 75: Raporti vjetor institucional]
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse	Ne dokumentacionin e paraqitur ne DVV, eshte perfshire Tabela 18 e RVB me te ardhurat dhe financimet ne 3 vitet e fundit deri ne Janar 2021, si edhe projekt buxheti afatmesëm ne te cilin jane detajuar te ardhurat dhe shpenzimet per vitet 21-22 deri ne 23-24. Në këtë projekt buxhet, midis të tjerash përfshihen pagat për stafin akademik të përfshirë në SHK, shpenzimet administrative, shpenzimet për bibliotekën fizike dhe atë dixhitale, shpenzimet për infrastrukturën e laboratorëve, konferencat, aktivitet sociale etj. Te gjitha zërat e mësipërme janë të domosdoshëm në funksion të mbarëvajtjes së programit të studimit dhe plotësimi të detyrimeve të ndryshme ndaj palëve të treta. Donacionet te realizuara ne masën 65% po ashtu kane ndikuar ne qëndrueshmërinë financiare te institucionit. [Shtojca ne RVB: Te ardhurat dhe financimet ne 3 vitet e


apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	fundit, Tabela 18] [Ev. nr. 75: Raporti vjetor institucional]			
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	KU Beder harton një raport të përvitshëm nga kontabiliste të miratuar, ku përfshihen zëra të hollësishëm financiarë në funksion të transparencës dhe përputhshmërisë me ligjet në fuqi. Në këtë raport janë detajuar burimet e të ardhurave dhe shpenzimet e ndryshme sipas nevojave në zbatimin e programeve të studimit. Raportet financiare përfshihen në raportin vjetor institucional që i paraqitet MAS. [Ev. nr. 75: Raporti vjetor institucional]			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Duke qenë se hapja e programit të studimit është miratuar për vitin akademik 2019-2020 dhe ende nuk është mbyllur një cikël i plotë studimi, institucioni megjithatë zbaton strategjinë e diversifikimit të burimeve të të ardhurave me qëllim të garantimit të qëndrueshmërisë financiare. Shpërndarja e burimeve financiare bëhet po ashtu në përputhje me standartet kombëtare dhe ligjeve në fuqi që trajtojnë raportet dhe pasqyrat financiare për organizatat jofitimprurëse. [Shtojca në RVB: Te ardhurat dhe financimet në 3 vitet e fundit, Tabela 18] [Ev. nr. 75: Raporti vjetor institucional]			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Duke marrë në konsideratë pasqyrat financiare mbi burimet e të ardhurave, institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare në vitet e fundit dhe synimi është që kjo qëndrueshmëri të ruhet edhe në vitet në vazhdim. Te ardhurat nga tarifatat e studenteve dhe donacionet kanë qenë brenda pritshmërive që garantojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike. Shtojca në RVB: Te ardhurat dhe financimet në 3 vitet e fundit, Tabela 18] [Ev. nr. 75: Raporti vjetor institucional]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>KU Beder ka të përcaktuara procedurat që duhet të ndiqen për pranimin e studenteve në baze të ligjit të arsimit të lartë 80/2015. Kriteret e pranimit miratohet çdo vit nga senati akademik dhe në baze të tyre bëhet edhe përzgjedhja e kandidateve. Po ashtu rregulloret e brendshme garantojnë vazhdimësinë e ciklit të plotë të studimeve deri në diplomimin e studentit. Pasi kanë fituar statusin e studentit, të gjithë të regjistruarit mund të shfrytëzojnë edhe infrastrukturën IT të institucionit për të bërë pjesë e komunikimit të brendshëm me zyrat përkatëse dhe stafin akademik.</p> <p>[Ev. nr. 33: Vendimi i senatit akademik për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programin BA në SHK][Ev. nr. 40: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë]</p>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	<p>Në KU Beder ngrihet një komision i posaçëm i cili vlerëson kandidatet sipas kriterëve të miratuara paraprakisht dhe që bëhen publike në faqen zyrtare duke garantuar që çdo student të gëzojë të njëjtat të drejta dhe barazi në procesin e pranimit. Institucioni ndjek po ashtu politika mbështetëse për disa kategori të veçanta siç janë studente me aftësi të kufizuara apo studentet ekselente duke ofruar bursa deri në 100% të tarifës së studimit. Rregulloret e institucionit përcaktojnë edhe kriteret që duhen plotësuar gjatë periudhës së studimeve për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin deri në diplomim.</p> <p>[Ev. nr. 17: Rregullorja Themelore] [Ev. nr. 40: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë]</p>
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të	<p>Rregullorja e programit të studimit Bachelor në SHK, përcakton kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve si edhe përgjatë periudhës së studimit në institucion. Rregulloret dhe kriteret bëhen publike për të interesuarit në faqen zyrtare ose të njëjsteve</p>

<p>me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>pasqyrohen edhe mënyrat e vlerësimit të dijeve. Informacionet ofrohen edhe ne kohe reale ne BIS. Pedagogu i lëndës shpjegon me hollësi elementet e programit te lendes dhe modulet e vlerësimit qoftë të ndërmjetëm apo përfundimtare. Për çdo modul vlerësimi përcaktohet pesha përkatëse dhe mënyra e llogaritjes së vlerësimit përfundimtar. Sistemi BIS ofron vazhdimisht informacione te plota mbi ecurinë e studentit përgjatë periudhës se studimeve. [Ev. nr. 31: Shembull syllabusi] [Ev. nr. 35: Udhezues i sistemit te informativ Beder - BIS] [https://bis.beder.edu.al/]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Studentet e vitit të tretë njihen me procedurat e diplomimit si edhe kriteret e punimit të diplomës sipas nje manuali per përgatitjen e tezës. Në mbështetje të diplomës zhvillohet një lëndë e posaçme e dedikuar kërkimit shkencor dhe shkrimin akademik ku studentet njihen me elementet më kryesore për përgatitjen e punimit të diplomës sipas rregulloreve perkatese. Gjate periudhës se përgatitjes se diplomës, cdo student ka nje udhëheqës me te cilin organizon seanca te detyrueshme konsultimi. <i>GVJ sygjeron qe te pregatitet nje manual i plote per përgatitjen e tezës ne gjuhen shqipe dhe nje tjetër suplementar si alternative ne gjuhen angleze duke pasur parasysh afërsinë e fushës me literaturën ne anglisht.</i></p> <p>[Ev. nr. 14: Rregullorja e programit “Bachelor ne Shkencat Kompjuterike”] [Ev. nr. 17: Rregullorja Themelore] [Ev. nr. 57: manuali per përgatitjen e tezës se diplomës dhe kriteret e vlerësimit te tezës per studentet e ciklit te pare] [Ev. nr. 59: Formati zyrtar i institucionit per punimin e diplomes] [Ev. nr. 73: Syllabusi i lendes “Metodat e Kerkimti dhe Shkrimi Akademik”]</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Informimi i te interesuarve për te vazhduar studimet pranë KU Beder realizohet nëpërmjet mjeteve dhe formave te ndryshme. Ndër to përfshihen rrjetet sociale, website zyrtare, materialet informuese, panairët e karrierës, takimet me maturantët etj. Po ashtu institucioni mban lidhje te ngushta me drejtoritë arsimore ku ftohen maturantët e shkollave të mesme per tu njohur me programet dhe infrastrukturën e universitetit.</p> <p>[Vizita e GVJ ne institucion – Takimi me studentet e programit SHK]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>KU Beder informon studentet ne javën e parë të shkollës dhe i njeh ata me stafin akademik, administrativ, strukturën e programit dhe të universitetit. Dekani, keshilltari akademik dhe instancat e tjera bëjnë një prezantim të njësisë kryesore, kurrikules së programit dhe zyrave përkatëse që ofrojnë shërbime të ndryshme të lidhura me programin e studimit SHK. Po ashtu studentet, nëpërmjet këshilltarit akademik informohen se ku duhet të drejtohen për zgjidhjen e problematikave që ata mund të kenë gjatë periudhës së studimeve. Nje rol te rëndësishëm ne informim luan sistmi BIS dhe faqja zyrtare e KUB.</p> <p>[Ev. nr. 14: Rregullorja e programit “Bachelor ne Shkencat Kompjuterike”][Ev. nr. 40: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te pare] [Vizita e GVJ ne institucion – Takimi me studentet e programit SHK]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Këshilltari akademik ne bashkëpunim me stafin akademik dhe sekretarinë mesimore ju vë në dispozicion studenteve planin mësimor me të gjitha lendet dhe modulet duke i udhëzuar ata mbi përmbajtjen atyre lëndëve, ngarkesën mesimore si edhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Informacione te hollësishme jepen edhe guidat e ndryshme dhe në sistemin BIS ku studentet mund të shohin orarin mësimor dhe prezencat si edhe ndarjen e leksioneve, seminareve dhe praktikave.</p> <p>[Ev. nr. 37: Guida e Studentit] [Vizita e GVJ ne institucion – Takimi me studentet e programit SHK]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka ngritur nje zyre per planifikimin e karrierës e cila eshte e lidhur me dekanatin e studenteve duke i orientuar ata mbi aspekte te ndryshme te punësimit mbas diplomimit. Keshilltari i karrierës mban lidhje të vazhdueshme me studentet për ti sinjalizuar për çdo mundësi në tregun e punës. Zyra po ashtu ofron mbështetje te vazhdueshme mbi teknikat e kërkimit te punësimit dhe aplikimit si edhe mbi krijimin e nje rrjeti alumni per studentet qe do te diplomohen ne përfundim te studimeve.</p> <p>[Ev. nr. 22: Vendimi i Këshillit te Departamentit per caktimin e përfaqësuesit pranë Zyres se Planifikimit te Karrieres] [Vizita e GVJ ne institucion – Takimi me</p>

	studentet e programit SHK]			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Me fillimin e procesit mësimor, studentet njihen me mënyrën e organizimit të tij në baze edhe të orarit mësimor. Ata po ashtu njihen me ambientet ku do të zhvillohet mësimi duke përfshirë klasat, laboratorët, sekretarinë mësimore dhe zyrat e shërbimeve. Keshilltari akademik merr përsipër orientimin dhe informimin e hollësishëm mbi aspektet e lidhura me zbatimin e planit mësimor. KU Beder i ka kushtuar një rëndësi të madhe edhe përmirësimit të infrastrukturës IT me laboratorë, tabela interaktive dhe projektorë bashkëkohore. [Vizita e GVJ ne institucion]			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Përveç faqes zyrtare të institucionit dhe rrjeteve sociale, mënyra më e shpejtë për të marrë informacione mbi programin e studimit dhe procesin mësimor, konsiderohet sistemi BIS i cili ofron akses në çdo kohë dhe po ashtu në distancë. Pasi pajisen me kredencialet përkatëse si edhe një adresë elektronike institucionale, studentet mund të aksesojnë sistemin dhe të gjejnë aty orarin, syllabuset e lendeve, informacion mbi stafin akademik si edhe vlerësimin mbi performancën akademike. [Vizita e GVJ ne institucion – Takimi me studentet e programit SHK] [Ev. nr. 35: Udhezues i sistemit të informativ Beder - BIS] [https://bis.beder.edu.al/]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	KU Beder, nëpërmjet sekretarisë mesimore, ruan të dhëna mbi regjistrimet e studenteve për çdo vit akademik duke krijuar një dosje personale për secilin prej tyre. Po ashtu ruhen edhe të dhëna mbi kalueshmërinë nga njeri vit akademik në tjetrin si edhe mbi transferimet nga universitetet e tjera me qëllim të përpunimit të dhënave statistikore. Për arsye se programi Bachelor në SHK është aktiv prej viti akademik 2019-2020, nuk ka ende të diplomuar.

	[Ev. nr. 74: Rregullorja e zyrës se sekretarisë mesimore][Tabela nr. 21 e RVB] [Vizita e GVJ ne sekretarinë mesimore]
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Mbarëvajtja e programit të studimit monitorohet vazhdimisht nga këshilltari akademik dhe sekretaria mesimore. Kjo e fundit ruan dhe përditëson statistikat mbi numrin e studenteve që regjistrohen, ndërpresin studimet apo transferohen brenda vitit akademik sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloret përkatëse. [Ev. nr. 74: Rregullorja e zyrës se sekretarisë mesimore][Tabela nr. 21 e RVB] [Vizita e GVJ ne sekretarinë mesimore]
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Institucioni ruan dhe përpunon të dhënat mbi ecurinë e studenteve përgjatë zbatimit të programit mesimor në Bachelor në SHK. Vlerësimet nga ana e stafit akademik shërbejnë si burime parësore për të ndjekur ecurinë e tyre deri në diplomim. Mbledhja e të dhënave bëhet nga zyrat përkatëse të cilat bashkëveprojnë me njëra tjetrën. [Ev. nr. 74: Rregullorja e zyrës se sekretarisë mesimore][Tabela nr. 21 e RVB] [Vizita e GVJ ne sekretarinë mesimore]
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi BIS mundëson një mbledhje dhe përpunim të shpejtë të rezultateve nga ku mund të nxirren përfundime mbi ecurinë e aktiviteteve të ndryshme akademike. Sistemi po ashtu mundëson gjenerimin e të dhënave statistikore në mënyrë periodike, të cilat më pas dërgohen tek instancat e autorizuara që mund të shfrytëzojnë këto të dhëna. [Vizita e GVJ ne sekretarinë mesimore] [Ev. nr. 35: Udhezues i sistemit te informativ Beder - BIS] [https://bis.beder.edu.al/]
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	KU Beder, harton raporte vjetore nga njesite baze dhe kryesore, dhe gjetjet e tyre pasqyrohen në raportin institucional. Në këtë mënyrë institucioni ruan dhe përpunon vazhdimisht statistika që lidhen me të dhënat e përgjithshme dhe cilësinë e studenteve të regjistruar si edhe do të vazhdojë me përpilimin e statistikave të studenteve që do të diplomohen për të analizuar në këtë mënyrë ecurinë e procesit mesimor. Si instance e rëndësishme koordinuese në këtë rast është këshilltari akademik i cili ndjek në mënyrë të drejtpërdrejtë ecurinë e studenteve duke shfrytëzuar edhe të dhënat nga sistemi BIS.

	[Ev. nr. 18: Rregullorja mbi organizimin akademik] [Ev. nr. 75: Raporti vjetor institucional]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	KU Beder ka ngritur disa organe sic jane Dekani i studenteve dhe presidenti i keshillit studentor te cilet bashkëpunojnë me instancat drejtuese per te adresuar problematikat dhe menaxhimin e marrëdhënieve me studentet. Qellimi i këtyre organeve eshte qe te garantohet përfshirja e studenteve në organe vendimmarrëse në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Studentet kanë përfaqësues në senatin akademik, në NJSBC si edhe ne Komisionin e Perhershëm per Garantimin e Standarteve dhe Cilesise. [Ev. nr. 10: Statuti i KU Beder] [Ev. nr. 46: Vendimi i senatit akademik per studentet përfaqësues ne mbledhje]
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Përfaqësimi i studenteve është në disa organe te cilat jane përmendur me lart. Institucioni, ne baze te nje rregulloreje te posacme, mundëson vlerësimin e punes se stafik akademik si nga ana e studenteve dhe eproreve ashtu edhe me ane te vetvleresimit. Anketimet zhvillohen ne menyre periodike përgjatë vitit akademik dhe opinioni i studenteve merret parasysh ne menyre te specifike në raportet që përpilohen mbi ecurinë e programit duke evidentuar edhe problematikat e mundshme ne procesin e mësimdhënies. [Ev. nr. 41: Rregullorja e anketave dhe vleresimeve] [Ev. nr. 42: Anketa e studentit ndaj lendes] [Ev. nr. 76: Ankete vlerësimi e studenteve ndaj institucionit]
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe	Institucioni aplikon një komunikim të vazhdueshëm me studentet për të marre prej tyre mendime mbi programin e studimit dhe kurrikulave të lëndeve. Për një vlerësim me të mire synohet të zhvillohet një procedure për marrjen e mendimeve nga studentet e diplomuar. Për shkak se akoma nuk ka një brez studentesh të diplomuar, procedura është lënë të zhvillohet në


parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	një periudhe të mëvonshme. Ngarkesa akademike shprehet me ane te krediteve te ECTS per harmonizimin me ligjet dhe rregulloret përkatëse si edhe per te mundësuar transferimin dhe njohjen e krediteve per studentet e transferuar. Procedura e transferimit kryhet nga nje komision ad-hoc mbas vlerësimit te dokumentacionit te ofruar konform rregulloreve mesimore. [Ev. nr. 32: Rregullorja e transferimit te studimeve]			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Ecuria e semestrit behet objekt takimi midis studenteve, këshilltarit akademik dhe përfaqësuesve te instancave drejtuese duke diskutuar çështje te ndryshme me interes per studentet. Bazuar ne anketimet e ndryshme dhe vlerësimeve, pergatiten raporte vjetore ku pqsqyrohen mendimet dhe kërkesat e studenteve. Po ashtu në lidhje me kurrikulat, në fillim të çdo viti akademik merren në shqyrtim propozimet nga ana e studenteve të cilët harmonizojnë në kurrikula kërkesat që vijnë edhe nga tregu i punës. [Ev. nr. 75: Raporti vjetor institucional]			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	KU Beder i jep mundësinë studenteve që të shprehin mendimet e tyre në lidhje me procesin e vlerësimit nga ana e stafit akademik. Bazuar ne rregulloret përkatëse, studentet kane të drejtë që të kërkojnë informacion mbi mënyrën e vlerësimit dhe ta kontestojnë ata nëse nuk janë dakord me vlerësimin. Rregullorja përcakton një procedure sipas të cilës lihet një jave afat pas nxjerrjes se rezultateve për ankimimin e tyre. Nje komision vlerësimi, ku pedagogu i lendes nuk eshte pjese, shqyrton ankesën dhe brenda 15 diteve jep vlerësimin final. [Ev. nr. 40: Rregullorja e studimeve dhe provimeve te ciklit te pare] [Vizita e GVJ ne institucion – Takimi me studentet e programit SHK]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në	Fakulteti i Teknologjise dhe Biznesit ofron infrastrukturën përkatëse me qellim informimin dhe mbështetjen e studenteve përgjatë periudhës së studimeve. Sekretaria mesimore, ajo e departamentit dhe instancat e tjera informojne studentet mbi

<p>përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>aspekte te ndryshme te programit te studimit sipas rregulloreve dhe ligjeve ne fuqi. Perfaqesuesit e studenteve ne organet perkatëse po ashtu kane mundësinë e informimit per çështje ne interes te tyre. [Vizita e GVJ ne institucion – Takimi me studentet e programit SHK] [Ev. nr. 14: Rregullorja e programit “Bachelor ne Shkenca Kompjuterike”]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>KU Beder ve ne dispozicion nje sere strukturash për të informuar dhe ndjekur ecurinë e procesit akademik të programit të studimit Bachelor ne SHK. Ketu përfshihen zyra e këshillimit te karrierës, seminaret e hapura dhe këshilltari akademik i cili ka kontakt të drejtpërdrejtë me studentet duke ndjekur ecurinë e tyre dhe duke marre opinione të vazhdueshme përgjatë studimeve. Departamenti i SHK synon vazhdimisht zhvillimin e aktiviteteve per përfshirjen e studenteve ne veprimtaritë akademike me ane te te ftuarve qe japin eksperiencat e tyre edhe nga tregu i punes.</p> <p>[Vizita e GVJ ne institucion – Takimi me studentet e programit SHK] [Ev. nr. 21: Vendim i Keshillit te Departamentit per miratimin e planit te aktiviteteve viti akademik 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Planifikimit të Karrierës është njësia përkatëse që mbështet dhe informon studentet përgjatë periudhës së studimeve deri në daljen e tyre në tregun e punës. Kjo njësi luan rolin e ndërmjetësit duke i këshilluar dhe orientuar studentet që të shfrytëzojnë mundësitë në tregun në përputhje me profilin e tyre. Keshilltari i karrierës si përfaqësues i kesaj zyre, luan nje rol te rëndësishëm ne orientimin e studenteve per te zhvilluar praktikat profesionale dhe per tu përshtatur ne tregun e punes.</p> <p>[Vizita e GVJ ne institucion – Takimi me studentet e programit SHK] [Ev. nr. 22: Vendim i Keshillit te Departamentit per caktimin e përfaqësuesit prane Zyrës se Planifikimit te Karrieres]</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe</p>	<p>Zyra e Planifikimit të Karrierës do të kujdeset po ashtu edhe për të mbajtur kontakte të vazhdueshme pas diplomimit, duke krijuar një strukture informacioni mbi punësimin e studenteve dhe karrierën në vazhdim. Ky funksion do të aplikohet mbas diplomimit të brezit të parë në vitin akademik 2021-2022. Insutucioni ka ngritur nje zyre te posacme e cila do te mbaje te dhënat lidhur me te diplomuarit dhe punësimin e tyre.</p>



organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	[Ev. nr. 19: Raport i zyrës se te diplomuarve viti 2019-2020]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Ne KU Beder funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshme të Cilësisë (NJSBC) e cila funksionon me qëllimin e monitorimit dhe koordinimit të aktiviteteve të cilat lidhen me procesin mësimor dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në programin bachelor ne SHK. Se bashku me dy komisione te përhershme, përkatësisht Komisioni i përhershëm per kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin si edhe Komisioni i përhershëm per garantimin e standardeve te cilësisë institucionale dhe programeve te studimit, NJSBC bashkërendon punën me njësitë e tjera kryesore për të përpiluar raporte vlerësimi për stafin akademik dhe pyetësorë për studentet si burime informacioni. Këto raporte shërbejnë për të hartuar një raport përfundimtar i cili i dorëzohet instancave drejtuese duke garantuar po ashtu edhe elemente të konfidencialitetit. Në baze të raportit përfundimtar, merren edhe vendimet përkatëse të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përmbushjen e standardeve te përcaktuara nga MAS. [Ev. nr. 44: Rregullorja per funksionimin dhe organizimin e NJSBC]
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe	NJSBC funksionon si njësi qe varet direkt nga rektori dhe ka akses ne te gjitha te dhënat e institucionit. Ajo përbëhet nga 5 anëtarë ku tre jane staf PAE, nje student dhe nje ekspert i jashtëm. Puna e NJSBC orientohet nga plani strategjik i

<p>zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>institucionit në drejtim të zbatimit të politikave dhe procedurave bashkëkohore bazuar në Standardet Kombëtare dhe Evropiane të Sigurimit të Cilësisë. Në bashkëpunim me komisionet e përhershme, ajo garanton sigurimin e cilësisë nëpërmjet vëzhgimeve dhe studimeve të vazhdueshme të cilat dokumentohen dhe përdoren në procesin e vlerësimit të procesit mesimor. Rezultatet e gjetjeve së bashku me propozimet përkatëse i paraqiten senatit akademik të institucionit. [Ev. nr. 12: Plani strategjik 2018-2023][Tabela nr. 24 në RVB – Te dhëna për anetaret e NJSBC]</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>NJSBC është e orientuar drejt përdorimit të praktikave më të mira për sigurimin e cilësisë duke e shtrirë vlerësimin në disa drejtime si atë të mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, literaturës së përdorur, teknikave të mësimdhënies dhe përbushjes e objektivave të programit SHK. Po ashtu sigurimi i jashtëm i cilësisë garantohej nëpërmjet procesit të akreditimit qoftë institucional ose të programeve që institucioni ofron. KU Beder ka kaluar disa akreditime institucionale duke fituar një eksperiencë të mirë në këto drejtime. Me anë të anketimit dhe vlerësimit merren të dhëna të cilat përdoren në raportet e vlerësimit apo vetëvlerësimit me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>[Ev. nr. 41: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve] [Ev. nr. 44: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>NJSBC vepron në nivel institucioni me varësi direkte nga rektori dhe veprimtaria e saj mbështetet në rregulloren përkatëse. Duke e konsideruar çështjen e cilësisë si mjaft të rëndësishme, KU Beder ndjek në mënyrë periodike procedura që synojnë të garantojnë përmirësimin e vazhdueshëm të saj në programin Bachelor në SHK duke angazhuar të gjithë organet institucionale që mund të kontribuojnë. Procedurat e vlerësimit përfshijnë vlerësimin e stafit, proceset administrative dhe punën kërkimore duke përdorur formularë dhe raporte të ndërmjetme të reflektuara më pas edhe në ato vjetore në nivel të NJSBC dhe institucional. Institucioni ka hartuar edhe një plan veprimi që synon të përmirësojë vlerësimin institucional të kerkimit shkencor në përputhje me strategjinë e zhvillimit 2018-2023. [Ev. nr. 12: Plani strategjik 2018-2023] [Ev. nr. 78: Plan veprimi për vlerësimin institucional të kerkimit shkencor]</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	KU Beder, sikurse është përmendur edhe me herët, ka ngritur njësi të posaçme të cilat monitorojnë zbatimin e programeve të studimit dhe bëjnë rishikimin e tyre në bazë të vlerësimeve nga burime të ndryshme si studentet dhe stafi akademik. Institucioni merr masa konkrete për tju përgjigjur mangësive apo nevojave për përmirësimin jo vetëm të programit të studimit por edhe të procesit mësimor në tërësi. NJSBC bashke me komisionet e përhershme monitoron vazhdimisht cilësinë në baze të kriterëve të përcaktuara në statut. [Ev. nr. 44: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC]
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Programet e studimit shqyrtohen vazhdimisht për përshtatjen e tyre me lëndet e kërkuara në tregun e punës duke angazhuar organet kolegjiale si edhe duke marrë në konsideratë edhe mendimin e studenteve. Grupet e punës së bashku me specialistë të fushës brenda apo jashtë institucionit, bëjnë propozimet përkatëse të cilat më pas miratohen nga senati akademik. Ndryshimi i programit të studimit bëhet konform rregullave të përcaktuara nga MAS duke kaluar nga njësi baze në ato kryesore dhe më pas në rektorat. [Ev. nr. 10: Statuti i KU Beder] [Ev. nr. 34: Praktika e ndryshimit në kurrikul]
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	KU Beder përdor metodologji të ndryshme për vlerësimin e ecurisë së programit të studimit Bachelor në SHK. Procesi i implementimit të tyre organizohet nga NJSBC e cila përpilon edhe raportet përkatëse të cilat ju dërgohen organeve të tjera si dekanatit dhe rektoratit. Metodologjia baze është ajo nëpërmjet anketimeve qoftë për studentet apo edhe për stafin akademik. Rezultatet finale bëhen publike duke ruajtur edhe elementet e privatësisë atje ku shihet e nevojshme. [Ev. nr. 44: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC]
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin	Rezultatet e vlerësimeve dokumentohen nga NJSBC dhe arkivohen për të ardhur në ndihmë procesit të rishikimit apo përmirësimit të programit në një kohë të mëvonshme. Përveç kësaj ato dërgohen në formë zyrtare tek autoritetet përgjegjëse të institucionit dhe mbas miratimit nga senati akademik, ato dërgohen në instancat përkatëse të MAS. [Ev. nr. 44:

e studimit.	Rregullorja per funksionimin dhe organizimin e NJSBC]			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Rezultatet e vlerësimit bëhen objekt diskutimi nga organet përkatëse dhe në baze të tyre bëhen edhe rekomandimet e nevojshme. Analiza e rezultateve të pritshme dhe atyre reale i shërben identifikimit të problematikave të mundshme si edhe zgjidhjes së tyre në funksion të përmirësimit të cilësisë së procesit të mësimdhënies. Rezultatet e vlerësimit behen publike brenda institucionit por edhe jashtë tij. [Ev. nr. 36: Guida e stafit] [Ev. nr. 44: Rregullorja per funksionimin dhe organizimin e NJSBC]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	KU Beder zbaton vlerësimin periodik të programit Bachelor ne SHK në fund të çdo semestri dhe me pas bën një analize vjetore mbi ecurinë e tij. NJSBC monitoron mbarëvajtjen e programit në disa drejtime dhe harton një raport të posaçëm i cili përfshihet në proceset e vlerësimit institucional apo atij të brendshëm në kuadër të akreditimeve. Formate të ndryshme vlerësimesh japin mundësinë e vlerësimit të studenteve për pedagoget [Ev. nr. 41: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve] [Ev. nr. 42: Anketa e studentit ndaj lendes] [Ev. nr. 80: Ankete vlerësimi e stafit akademik/administrativ ndaj institucionit]
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Institucioni përdor metoda të ndryshme të vlerësimit duke i harmonizuar ato për të nxjerrë përfundime sa më reale në përputhje me natyrën dinamike të programit të studimit Bachelor ne SHK. Në vlerësim përfshihen të gjitha palët që kontribuojnë në këtë program duke dhënë në këtë mënyrë informacionin më të nevojshëm për një analize sa më saktë. Raportet vjetore prezantohen hapur nga njesite qe i kane përpiluar ato duke u bere objekt diskutimi dhe duke shkëmbyer mendime dhe përvoja mbi përmirësimet e mundshme ne kurrikula. [Ev. nr. 34: Praktika e ndryshimit

	ne kurrikul] [Ev. nr. 41: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve]			
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Vlerësimet kryhen në mënyrë të drejtpërdrejtë tek palët që përfshihen në zbatimin e programit. Vlerësimi i kurrikules behet në mënyrë periodike duke zbatuar aktet ligjore në fuqi nëse është i nevojshëm ndryshimi. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies behet kryesisht nëpërmjet anketave të lendes dhe stafit akademik. NJSBC angazhohet në procesin e vlerësimit për të qene edhe në përputhje me pritshmerite mbi realizimin e mbarëvajtjes së cilësisë së programit bachelon në SHK. [Ev. nr. 41: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve]			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Palët që përfshihen në programin e studimit SHK, janë objekt vlerësimi nëpërmjet metodave të përmendura me herët si edhe atyre që quhen metoda të tërthorta. Vëzhgimet, intervistat apo edhe diskutimet ballë për ballë përfshihen tek elementet shtesë të vlerësimit duke inkurajuar vazhdimisht përmirësimin e cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe zbatimit të programit në tërësi. Një element i rëndësishëm do të jetë edhe mendimi dhe vlerësimi i të diplomuarve në fund të vitit akademik 2021-2022 duke plotësuar në këtë mënyrë të gjithë kuadrin e vlerësimit. [Ev. nr. 41: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve] [Ev. nr. 42: Anketa e studentit ndaj lendes] [Ev. nr. 80: Ankete vlerësimi e stafit akademik/administrativ ndaj institucionit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>KU Beder ka synuar të organizojë një vlerësim gjithëpërfshirës të të gjithë aktoreve të interesuar për përmirësimin e cilësisë përfshirë përfaqësuesin e keshillit studentor dhe ekspertin e jashtëm. Politika e zhvillimit të institucionit mbështetur mbi planin strategjik, inkurajon stafin akademik për të rritur performancën nëpërmjet kualifikimeve dhe trajnimeve të vazhdueshme. NJSBC koordinon procesin dhe nëpërmjet marrëdhënieve me palët përkatëse për të garantuar një transparencë të plotë.</p> <p>[Ev. nr. 44: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC] [Ev. nr. 45: Lista e trajnimeve për stafin 2014-2020]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Te gjitha palët e përfshira në programin Bachelor në SHK si edhe organet përkatëse kanë detyra specifike në lidhje me sigurimin e cilësisë. NJSBC së bashku me Komisionin e përhershëm të garantimit të cilësisë, kujdesen që secila prej tyre të përmbushi me sukses këto detyra duke raportuar më pas tek organet drejtuese. Në bazë të rezultateve merren edhe masat përkatëse qoftë për stafin akademik apo atë administrativ në bashkëveprim me njesite kryesore dhe organet vendimmarrese, ku përfshihen edhe studentët. [Ev. nr. 44: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC]</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë bëhet duke përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë njësitë përgjegjëse për zbatimin e programit dhe stafin akademik dhe administrativ si edhe studentet. Në analizat vjetore, çështjet e mësipërme behen objekt diskutimi nga stafi akademik duke ju mundësuar atyre shkëmbimin e përvojave për përmirësimet e mundshme. Rezultatet e vlerësimit më pas shërbejnë për të analizuar ecurinë e programit dhe për të marrë masat përkatëse në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të treguesve të cilësisë.</p> <p>[Ev. nr. 44: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC] [Vizita e GVJ në institucion – Takimi me studentet dhe stafin akademik të programit Bachelor në SHK]</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të</p>	<p>Procesi i vlerësimit është gjithëpërfshirës duke respektuar elementin e barazisë dhe integritetin e stafit akademik dhe</p>

<p>brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>studenteve. Ky proces është bazuar në një rregullore të posaçme mbi anketat dhe vlerësimet. Po ashtu stafi akademik kalon në procesin e vetëvlerësimit si edhe vlerësimit qoftë nga koleget apo eprorët. [Ev. nr. 41: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve] [Ev. nr. 50: Formulari i vetëvlerësimit] [Ev. nr. 80: Anketë vlerësimi e stafit akademik/administrativ ndaj institucionit]</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Natyra dinamike e programit të studimit Bachelor në SHK kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm me profesioniste dhe ekspertë të fushës akademike por jo vetëm. Futja e lendeve të reja dhe eksperiencia nga aktoret e industrisë garanton një përshtatje me të mirë të programit me kërkesat e tregut të punës. Leksionet e hapura nga profesioniste të ftuar shërbejnë për shkëmbim mendimesh dhe përmirësimin në vazhdimësi të kurrikules. Departamenti i Shkencave Kompjuterike planifikon për çdo vit akademik listën e aktiviteteve në formën e prezantimeve me pjesëmarrjen e eksperteve dhe profesionisteve nga akademia apo industria.</p> <p>[Ev. nr. 21: Vendim i Keshillit të Departamentit për miratimin e planit të aktiviteteve, viti akademik 2020-2021]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.5</p> <p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>NJSBC në bashkëpunim me instancat e tjera harton raportet përkatëse të cilat ju dorëzohen organeve drejtuese të rektoratit. Keto më pas organizojnë një mbledhje të hapur me stafin akademik dhe përfaqësuesit e studenteve ku bëhet në mënyrë transparente prezantimi i gjetjeve. Ato të dhëna që janë specifike prezantohen dhe dërgohen në forma që garantojnë konfidencialitetin dhe etikën akademike. Raportet bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit. [Ev. nr. 75: Raporti vjetor institucional, viti akademik 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të</p>	<p>Publikimi i të dhënave të vlerësimit bëhet konform ligjeve për të dhënat personale si edhe duke respektuar privacinë kur është e nevojshme. Gjetjet bëhen publike nëpërmjet prezantimeve</p>

studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	apo edhe sistemit online. Institucioni respekton etiken akademike për të mos cenuar të drejtat dhe personalitetin e asnjë anëtarë të stafit. [Ev. nr. 41: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve]			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e vlerësimit diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre. Rishikimi i procesit të mësimdhënies, literaturës, kurrikules dhe infrastrukturës duhet të çojë në përfundime që synojnë përmirësimin e cilësisë dhe motivimin e të gjitha palëve në funksion të atij qëllimi. Grupet e punës janë përgjegjëse për hartimin e planveprimeve. [Ev. nr. 75: Raporti vjetor institucional, viti akademik 2020-2021]			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	NJSBC koordinon informacionet e marra dhe siguron në vazhdim efikasitetin e procedurave të vlerësimit dhe i përmirëson ato sipas gjetjeve. Monitorimi i vazhdueshëm dhe organizimi i aktiviteteve tjera plotësuese në funksion të vlerësimit të cilësisë i kanë dhënë një rëndësi të veçantë veprimtarisë së NJSBC. Gjetjet e deritanishme kanë shërbyer për të bërë përmirësime të vazhdueshme në programin e studimit Bachelor ne SHK në tërësi dhe elementeve përbërës në veçanti. Zbatimi i planveprimeve konsiderohet i rëndësishëm në aspektin e masave që merren për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. [Ev. nr. 44: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC]			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	KU Beder nëpërmjet NJSBC organizon veprimtari të ndryshme në formën e takimeve dhe njoftimeve duke vënë theksin tek rëndësia e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit Bachelor ne SHK. Të gjitha palët inkurajohen të bëhen pjesë e procesit pasi dhënia e mendimeve sa më objektive ndihmon në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e ofruar në nivel programi studimi. Institucioni organizon aktivitetet që kanë të bëjnë me orientimin e studenteve duke pasur si qëllim ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e përmirësimit të cilësisë në terma afatgjatë. [Ev. nr. 75: Raporti vjetor institucional, viti akademik 2020-2021]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
---------------------------------	------------	-------------------	-------------------	-------------------



standardeve të fushës VI	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura, në dispozicion të programit të studimit, ofrojnë hapësirat dhe kushtet e nevojshme laboratorike për procesin mësimor;
2. Programi i studimit është inovativ dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës;
3. Funksionimi i një sistemi tutorati në shërbim të komunikimit me studentët, me qëllim ndjekjen e problematikave që lidhen me procesin mësimor, qasjen në literaturë dhe çështje të tjera që lidhen me jetën studentore;
4. Vlerësimi i rregullt i institucionit në tërësi dhe stafit akademik nga studentët për këtë program studimi;
5. Angazhimi si staf akademik, i specialisteve me përvojë në kompani të ndryshme në fusha specifike të programit të studimit si edhe bashkëpunimi me institucione të administratës publike;
6. Angazhimi i studentëve të këtij programi studimi në projekte dhe aktivitete me fushën specifike të programit të studimit;

b. Pika të dobëta:

1. Njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, ka një numër relativisht të ulët të stafit akademik PAE me formim specifik në fushën e këtij programi studimi;
2. Literatura e detyruar e përdorur në lëndët e këtij programi studimi nuk është gjithmone e azhurnuar në 5 vitet e fundit;
3. Zhvillimi i testeve të vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim nuk realizohet gjithmonë në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim;

Rekomandime:

1. Të rritet numri i stafit të brendshëm (PAE) me kualifikim specifik në fushën e programit të studimit;
2. Të azhurnohen plan-programet e lëndëve me literaturë bashkëkohore të 5 viteve të fundit;
3. Të vendosen rregullore zhvillimi në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim i testeve të vlerësimit të njohurive dhe dijeve me shkrim;

<p>studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>kryesore dhe baze të institucionit. Të interesuarit mund tju drejtohen direkt edhe zyrave përkatëse brenda institucionit.</p> <p>[Ev. nr. 14: Rregullorja e programit “Bachelor ne Shkencat Kompjuterike”] [Ev. nr. 33: Vendimi i senatit akademik per miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programin BA në SHK]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Në baze të ligjit të arsimit të lartë 80/2015, në përfundim të çdo viti akademik, hartohen kriteret akademike të veçanta për përzgjedhjen e studentëve që do të pranohen në vitin akademik pasardhës. Këto kriterë janë në përputhje edhe me udhëzimet që dalin për çdo vit nga institucionet e tjera siç është Ministria e Arsimit dhe Sportit. Institucioni paraqet ofertën akademike në formë të ndryshme duke bashkëpunuar me drejtoritë arsimore dhe panairëve të karrierës.</p> <p>[Ev. nr. 14: Rregullorja e programit “Bachelor ne Shkencat Kompjuterike”][Ev. nr. 33: Vendimi i senatit akademik per miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programin BA në SHK]</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>KU Beder, nëpërmjet organeve të brendshme përcakton kriteret specifike dhe ato të përgjithshme, duke i përshtatur sipas akteve nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në përputhje edhe me kriteret e maturës shtetërore. Midis të tjerash përcaktohen edhe procedurat dhe kuotat për regjistrimin e studentëve të huaj apo ata të ardhur nga trevat shqiptare jashtë vendit. Informacioni behet publik përmes faqes zyrtare të institucionit.</p> <p>[Ev. nr. 14: Rregullorja e programit “Bachelor ne Shkencat Kompjuterike”][Ev. nr. 33: Vendimi i senatit akademik per miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programin BA në SHK]</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>KU Beder, përpara fillimit të vitit akademik, publikon në faqen zyrtare si edhe rrjetet sociale, broshurat, panairëve etj. ofertën akademik dhe kriteret për të gjithë të interesuarit duke i udhëzuar ata edhe për filtrat që mund të vendosen në rast të tejkalimit të kuotave. Kriteri kryesor i përzgjedhjes në raste të tilla mbetet cilësia e kandidateve e cila garantohet nga një komision i posaçëm i ngritur për këto qëllime. Po ashtu edhe zyra e informimit të studentëve luan një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve. Publikimit të kriterëve dhe kërkesave i paraprin një fushatë propocionale për informimin e maturanëve mbi programet e ofruara. [Ev. nr. 33: Vendimi i senatit akademik per miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programin BA në SHK] [Ev. nr. 72: Vendimi</p>

	per ngritjen e Komisionit per Vleresimin dhe Perzgjedhjen e Studenteve]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>KU Beder vë në dispozicion informacionin përkatës për procedurat që ndiqen gjatë studimeve dhe që lidhen me kalimin nga njeri vit akademik në tjetrin. Sipas Nenit 21 të rregullores së studimeve të programit “Bachelor në Shkencat Kompjuterike, studenti kalon nga viti i parë në atë të dytë kur ka siguruar të paktën 30 kredite të lendeve të vitit të parë dhe në atë të tretë kur ka siguruar të paktën 60 kredite nga viti i parë dhe i dytë. Studenti që ka ende 30 kredite të pa shlyera para diplomimit, mund të likujdojë ato me kusht që të ketë përmbushur detyrimin e frekuentimit të lendeve. Informacioni është pasqyruar në format fizike dhe online në rregulloret përkatëse dhe është i aksesueshem nëpërmjet guidave pranë sekretarisë mesimore apo Departamentit të Shkencave Kompjuterike. Keshilltari akademik i programit Bachelor në SHK është po ashtu i angazhuar për informimin e studenteve mbi progresin e tyre.</p> <p>[Ev. nr. 14: Rregullorja e programit “Bachelor në Shkencat Kompjuterike”] [Ev. nr. 17: Rregullorja Themelore] [Ev. nr. 37: Guida e Studentit]</p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Për të gjithë studentet që dëshirojnë të transferohen, jepet informacion paraprak mbi njohjen e krediteve apo kualifikimeve të mëparshme të fituara si rezultat i studimeve me kohe të plote apo të pjesshme në institucione arsimore të tjera. Për çdo rast zbatohet me rigorozitet rregullorja përkatëse. Njohja e krediteve bëhet nga një komision ad-hoc për zgjedhës i cili argumenton njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin sipas kriterëve të KU Beder. [Ev. nr. 32: Rregullorja e transferimit të studimeve] [Ev. nr. 72: Vendimi për ngritjen e Komisionit për Vlerësimin dhe Perzgjedhjen e Studenteve]</p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje	<p>Në javën e parë të fillimit të çdo viti akademik, studentet informohen mbi programet e lëndëve ku midis të tjerash</p>

Conclusions of the Evaluation of the study program Bachelor in "Computer Science"

a. Strengths and affirmations:


1. Appropriate environments and infrastructure, available to the study program, provide the necessary laboratory spaces and conditions for the learning process;
2. The study program is innovative and in line with the needs of the labor market;
3. The establishment of a tutoring system for communication with students, in order to monitor issues related to the learning process, access to literature and other issues related to student life;
4. Regular evaluation of the institution as a whole and the academic staff by the students for this study program;
5. Engagement as academic staff of specialists with experience in different companies in specific fields of the study program as well as cooperation with public administration institutions;
6. Engagement of students of this study program in projects and competitions related to the specific field of the study program;

b. Weaknesses:

1. The department responsible for this study program has a low number of effective academic staff with specific academic competencies on related subjects of this study program;
2. The compulsory literature used in the subjects of this study program is not always updated with editions of the last five years;
3. The development of knowledge assessment tests, written knowledge is not always done anonymously by secreting or codifying;

Recommendations:

1. To increase the number of internal staff (PAE) and with specific qualification in the field of the study program;
2. To update the course plans with contemporary literature of the last five years;
3. To establish regulations of anonymous testing by secreting or codifying written knowledge assessment tests;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së Programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Kompjuterike

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X